

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 5975  
E martë, 14 janar 2020  
çmimi 0.40 €

Kompania e cila po planifikon të ndërtojë në zonën e Badovcit nuk ka leje ndërtimi



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

SHTOHET PRESIONI AMERIKAN PËR FORMIMIN E QEVERISË SË RE

# SHBA-ja KËRKON FORMIMIN E QEVERISË SË RE



Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett, ka kërkuar të hënën nga spektri politik formimin e qeverisë së re. Derisa ka takuar liderin e LDK-së, diplomati amerikan ka vlerësuar që sa

më parë duhet të përmbushet mandati i votuesve. Dy partitë fituese që po negociojnë për formimin e qeverisë kanë fajësuar njëra-tjetrën për bllokim të procesit. Zyrtarët e LDK-së kanë thënë se zgjidhjen për situatën duhet

të bëjë Lëvizja Vetëvendosje si fituese e zgjedhjeve të 6 tetorit, ndërsa kjo e fundit ka fajësuar LDK-në për bllokim të negociatave, duke thënë se partia e Isa Mustafës po kërkon që t'i kthehet posti i kryetarit të Kuvendit

## MF-ja: Nëse nuk miratohet Ligji për buxhetin, nga 28 shkurti nuk mund të bëhet asnjë pagesë

Ministria e Financave ka paralajmëruar se në rast të mosmiratimit të ligjit të ri për buxhetin nga Qeveria e re dhe Kuvendi, të gjitha

pagesat, përfshirë pagat që nga organet e sigurisë e deri te shërbimi civil, pensionet dhe asistencat e tjera sociale, shërbimet publike si dhe të

gjitha obligimet e tjera buxhetore, do të ndërpriten nga 28 shkurti, përkatësisht 31 marsi, nëse ka vendim nga Kuvendi

## Kosova, drejt krizës për ujë të pijshëm



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Curez-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princasha-ks.com](http://www.princasha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## OPINION

**KOALICIONI LV - LDK BESOJ SE DO TË BËHET, POR.. .POR, A DO TË JETË VËRTET I SHPRESËS?! F. 10-11**

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



**DEBLOKADA E VULLNETIT TË SOVRANIT F. 8**

Shkëlzen MALIQI



## AKTUALE

**PËRURORHET CT-JA E RE NË SPITALIN E GJILANIT F. 7**



## EKONOMI

**INSPEKTORATI I MTI-së KONFISKON MALLRA TË FALSIFIKUARA F. 9**

## SPORT

**LOJTARËT E SUPERLIGËS U PARAQITËN MIRË PËR KOSOVËN F. 20**



# Shtohen shpresat e Shqipërisë për fillimin e negociatave me BE-në

Shpresat për arritjen e kompromisit në favor të hapjes së negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, me rregullat ekzistuese, janë gjallëruar javën e kaluar, kur presidentja e KE-së, Ursula von der Leyen, deklaroi në Zagreb se ne nuk duhet t'i ndryshojmë tani kushtet apo rregullat për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut



Tiranë, 13 janar - Shpresat për zhblokimin e hapjes së negociatave të anëtarësimit vijnë këtë fillim viti nga Franca, Komisioni i ri Evropian dhe Presidenca Kroate e Këshillit Evropian, mbështetëse e fortë e anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. Pritshmëritë e Shqipërisë drejtohen te samiti i Zagrebit, i cili do të mbahet me 6-7 maj, i konsideruar si ngjarja më e rëndësishme e Presidencës kroate, që ka nisur punën me moton, "Një Evropë e fortë, në një botë sfi-dash".

Që Franca po rishikon qëndrimin e saj për të zhblokuar hapjen e negociatave e bëri publike presidenti Macron, në takimin e tij në Paris me kryeministrin kroat Andrej Plenković. Presidenti francez deklaroi se "Franca uron që samiti i Zagrebit të jetë një moment uniteti dhe një sukses për Evropën". Në rastin konkret, uniteti dhe suksesi do të realizohen nëse samiti i Zagrebit ia del mbanë t'u japë Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, një datë për hapjen e negociatave të pranimit.

Gledis Gjipali, Drejtor i "European Movement"-Albania, me seli në Tiranë, thotë për Dutsche Eellen se

deklarata e presidentit Macron nënkupton arritjen e një konsensusi të gjitha vendeve anëtare të BE-së për t'i hapur negociatat me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

"Kemi një fleksibilitet në rritje të presidentit Macron kundrejt vendimit të tij të prerë në tetorin e kaluar, kur bllokoj procesin e zgjerimit deri në reformimin e metodologjisë së procesit të zgjerimit. Deklarata e tij për një samit të suksesshëm uniteti nënkupton vullnetin e Francës për të zgjidhur ngërçin e zgjerimit", thotë për DË, Gledis Gjipali. Deklarata shpresëdhënëse e presidentit Macron për rishikim të qëndrimit bllokues të Francës u shoqërua me vlerësimin për ndryshimet e pritshme në metodologjinë e procesit të negociatave. Ai i quajti ato "një parakusht për hapjen e negociatave me vendet candidate" edhe pse ndryshimet e propozuara nga Franca janë pritur ftohtë nga një numër i konsiderueshëm vendesh anëtare të BE-së.

Në një propozim drejtuar Komisionit Evropian, në mes të dhjetorit të kaluar, 9 vende anëtare të BE-së- Austria, Çekia, Estonia, Italia, Letonia, Lituania, Malta, Polonia dhe

Slovenia - i propozojnë KE-së që "ndryshimet në metodologjinë e procesit të zgjerimit të mos ndikojnë në vendimin për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut".

"Propozimi alternativ i 9 vendeve anëtare të BE-së është një kundërpërgjigje ndaj atij francez që vendos reformimin e metodologjisë së procesit të zgjerimit, para marrjes së vendimit për Shqipërinë dhe MV. Në këto kushte, që procesi i hapjes së negociatave të zhblokohej, e vetmja rrugë është arritja e një kompromisi. Evropa është e bazuar mbi kompromisin", thotë Gledis Gjipali.

Shpresat për arritjen e kompromisit në favor të hapjes së negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, me rregullat ekzistuese, janë gjal-

lëruar më tej të premtën, kur presidentja e KE-së, Ursula von der Leyen, deklaroi në Zagreb, në konferencën e për-bashkët për shtyp me kryeministrin kroat, Andrej Plenković se ne nuk duhet t'i ndryshojmë tani kushtet apo rregullat për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

"Ne duhet t'i mbajmë premtimet tona. Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë përmbushur kriteret që u kemi kërkuar për fillimin e bisedimeve të pranimit në BE. Qëllimi është të sigurojmë Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut se dera është e hapur dhe ato mund t'i fillojnë bisedimet e anëtarësimit", tha Leyen.

Qartë dhe pa ekuivok presidentja e KE-së ka folur të premtën në Zagreb për "një proces paralel rinovimi të

metodologjisë me vijimin e procesit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut", qëndrim ky i kundërt me atë të presidentit francez Macron, që kundërshton hapjen e negociatave për dy vendet përpara reformimit të metodologjisë. Ajo tha gjithashtu se do të propozojë ndryshime "në fillim të vitit" të mënyrës se si BE-ja skanon vendet që aspirojnë anëtarësimin. Në tetorin e kaluar Franca bllokoj hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut gjatë 6 muajve të parë 2020, për të bërë të mundur sipas saj një shqyrtim të kujdesshëm të zbatimit të ligjit në dy vendet. KE-ja i dha Shqipërisë statusin e vendit kandidat për anëtarësim në vitin 2014, pesë vjet pas aplikimit të saj për të qenë vend anëtar i BE-së.

## OSBE-ja e gatshme të punojë me autoritetet shqiptare për Ligjin mbi mediet

TIRANË, 13 JANAR - Përfaqësuesi i OSBE-së për shtypin, Harlem Desir tha të hënën se ai është i gatshëm të punojë me autoritetet shqiptare për përmirësimin e ligjit të shtypit, veçanërisht atyre pjesëve që lidhen me gjobat dhe parimin e proporcionalitetit siç parashikohet në ligjin ndërkombëtar.

Zyra e OSBE-së për shtypin e bëri këtë deklaratë pas marrjes së dokumenteve shpjeguese nga presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta për arsye të mosdekretimit të Ligjit për shtypin në Shqipëri. "Përfaqësuesi i medias përsërit

se asnjë pjesë e legjislacionit të ri nuk duhet të pengojë lirinë e shprehjes dhe lirinë e shtypit. Ai shpreson se rivotimi i ligjit do t'u hapë rrugën sqarimeve dhe përmirësimeve të mëtejshme të këtij ligji në mënyrë që të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare", thuhet në deklaratën e zyrës së OSBE-së për lirinë e medias.

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta ktheu për rishqyrtim në parlament ndryshimet në dy ligje "Për mediet audiovizive" dhe "Për komunikimet elektronike". Sa i takon ligjit të parë,

presidenti Meta vlerëson se ai bie ndesh me parimet themelore kushtetuese të ndërtimit të një shteti demokratik, sigurisë juridike dhe të proporcionalitetit.

Ndërsa lidhur me ndryshimet në ligjin "Për komunikimet elektronike" presidenti Meta shprehu shqetësim për fuqinë e tepërt ndëshkimore që merr AKEP ndaj mediave. Qeveria e Shqipërisë dhe shumica socialiste në parlament kanë këmbëngulur se paketa anti-shpifje ka mbështetur plotësisht OSBE-së.



# Kompania e cila po planifikon të ndërtojë në zonën e Badovcit nuk ka leje ndërtimi



Ministri në detyrë i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, dhe kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, kanë reaguar në lidhje me ndërtimet pranë liqenit të Badovcit të cilat kanë nxitur reagime të shumta të qytetarëve. Matoshi dhe Ahmeti kanë bërë me dije të hënën se asnjë kompani dhe as ndonjë pronar i tokës nuk kanë aplikuar dhe nuk janë pajisur me pëlqim mjedisor nga MMPH-ja dhe Komuna e Prishtinës për projektin i cili synon të ndërtohet afër liqenit të Badovcit

në bazë të të gjitha të dhënave që kemi në MMPH ju sigurojmë se as kompanitë në fjalë dhe as pronari i tokës nuk ka aplikuar dhe nuk është pajisur me pëlqim mjedisor nga MMPH-ja", ka thënë ministri Matoshi. Ai ka theksuar se sipas kompetencave si MMPH, përveç pjesës së planifikimit hapësinor, ministria që drejton është përgjegjëse edhe për zonat e mbrojtura dhe në rastin konkret, Zonën e Mbrojtur Ujore të Liqenit të Badovcit, sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 16/127, të datës 24. 04. 2013. "Andaj çfarëdo zhvillimi i planifikuar në atë pjesë duhet të jetë në përputhje të plotë me legjislacionin dhe kriteret e parapara si dhe t'u nënshtrohet lejeve përkatëse dhe procedurave të parapara me ligj, vetëm pas këtyre procedurave mund të konstatohet se a mund të realizohen projektet e tilla ose jo. Lidhur me këto shqetësime sot i kemi dërguar një shkresë për të kërkuar informata nga Komuna e Prishtinës. Dëshiroj t'ju siguroj juve dhe të gjithë qytetarët e vendit, se inspektorati i MMPH-

së dhe departamentet e tjera përgjegjëse brenda MMPH-së do të jetë aktive në këtë çështje dhe do të kujdesen që të mos ndodhë asnjë veprim i cili mund ta cenojë zonën e mbrojtur të liqenit të Badovcit dhe kualitetin e ujit nga kushdo qoftë", është shprehur ministri Matoshi. Për këtë rast ka reaguar edhe kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, i cili ka thënë se uji i pijshëm 24h në Prishtinë nuk bën të rrezikohet dhe nuk do të rrezikohet. Ai ka thënë se liqeni i Badovcit është pasuri shtetërore në pronësi të shtetit të Republikës së Kosovës sikurse edhe çdo resurs tjetër ujor. "Vendimet për mbrojtjen e liqenit/ujit dhe masat e tjera mbrojtëse i merr niveli qendror, sepse i kanë edhe përgjegjësitë edhe kapacitetet të bëjnë vlerësime të tilla. Komuna e Prishtinës është përgjegjëse për leje ndërtimore sipas dokumenteve planifikuese që i ka në fuqi, dokumentet kryesore të të cilave janë aprovuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës në vitin 2013. Kompania në fjalë nuk ka leje ndërtimi dhe ende

nuk ka aplikuar për leje ndërtimi. Kompania në fjalë ka aplikuar për kushte ndërtimore të cilat i paraprijnë aplikimit për leje. Në këtë procedurë është që disa vite. Në Kushtet Ndërtimore i thuhet se para se të aplikojë për leje në Komunën e Prishtinës, duhet të aplikojë për pëlqimin për vlerësimin mjedisor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të cilën ende nuk e ka bërë", ka thënë Ahmeti. Ai ka shtuar se në vitin 2015 Komuna e Prishtinës ka propozuar rritjen e territorit të Gërmisë nga 900 hektarë në 2 000 hektarë dhe ka marrë statusin e peizazhit të mbrojtur sipas ligjeve në fuqi. "Një pjesë e peizazhit është rreth Badovcit. Në vitin 2016, në bashkëpunim me Qeverinë e Çekisë, kemi arritur ta fillojmë trajtimin e ujërave të zeza përreth liqenit. Ujëra të tilla nuk derdhen më në liqenin e Badovcit", ka deklaruar kryetari Ahmeti, duke bërë me dije se Prishtina ka ujë të pijshëm 24 orë në ditë që nga viti 2017 dhe kjo në asnjë mënyrë nuk bën dhe nuk do të rrezikohet.

**EPOKA  
ERE****Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 13 JANAR** - Ministri në detyrë i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, dhe kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, kanë bërë me dije të hënën se asnjë kompani dhe as ndonjë pronar i tokës nuk kanë aplikuar dhe nuk janë pajisur me pëlqim mjedisor nga MMPH-ja dhe Komuna e Prishtinës për projektin i cili synon të ndërtohet afër liqenit

të Badovcit. "Bazuar në njoftimet e bëra nga ana e një grupi të qytetarëve si dhe ngritja e shqetësimit të mediave lidhur me iniciativën rreth një projekti i cili synon të ndërtohet afër Liqenit të Badovcit nga investitori 'KAWA Group', '4M Group' si dhe një pronari privat të tokës (Rahman Hajredini), dhe që në vazhdimësi është duke u potencuar se MMPH-ja ka dhënë leje për një projekt të tillë, ju informoj se MMPH-ja nuk ka kompetenca që në këtë rast të lëshojë leje ndërtimore. Gjithashtu,

## Fondi i Grave të Kosovës ndan rreth 200 mijë euro për 14 organizata të rajonit

**PRISHTINË, 13 JANAR (ER)** - Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) dhe partnerët në koalicionin e organizatave të të drejtave të grave në Ballkanin Perëndimor përmes Fondit të Grave të Kosovës kanë ndarë grante për organizatat e

shoqërisë civile (OSHC), në vlerë prej 200 mijë eurosh. Këto grante janë pjesë e iniciativës "Promovimi i të Drejtave të Punës për Gratë", e cila financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe bashkëfinancohet nga

Bashkëpunimi Suedez për Zhvillim. Nga 14 organizata përfituese të granteve, dy organizata të OShC-ve janë nga Kosova, të cilat nënshkruan kontratat të hënën: Instituti i Kosovës për Drejtësi në

Prishtinë, me iniciativën "Përmirësimi i të drejtave të grave në punë" (19 950 euro), i cili do të ofrojë ndihmë juridike dhe do t'i monitorojë gjykatat; dhe Qendra Kosovare për Studime Gjinore në Prishtinë,

me iniciativën "Parandalimi i diskriminimit të të gjitha formave në vendin e punës" (10 000 euro), e cila do të kontribuojë në vetëdijësimin dhe fuqizimin e grave për ta raportuar diskriminimin.



SHTOHET PRESIONI AMERIKAN PËR FORMIMIN E QEVERISË SË RE

# SHBA-ja KËRKON FORMIMIN E QEVERISË SË RE

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett, ka kërkuar të hënën nga spektri politik formimin e qeverisë së re. Derisa ka takuar lidërshtipin e LDK-së, diplomati amerikan ka vlerësuar që sa më parë duhet të përmbushet mandati i votuesve. Dy partitë fituese që po negociojnë për formimin e qeverisë kanë fajësuar njëra-tjetrën për bllokim të procesit. Zyrtarët e LDK-së kanë thënë se zgjidhjen për situatën duhet të bëjë Lëvizja Vetëvendosje si fituese e zgjedhjeve të 6 tetorit, ndërsa kjo e fundit ka fajësuar LDK-në për bllokim të negociatave, duke thënë se partia e Isa Mustafës po kërkon që t'i kthehet posti i kryetarit të Kuvendit

Mustafa. Të njëjtën gjë e ka thënë edhe nënkryetari i LDK-së, Agim Veliu, i cili, së bashku me dy nënkryetarët e tjerë, Vjosa Osmani dhe Lutfi Haziri, kanë takuar ambasadorin Kosnett. Sipas Velikut, LDK-ja po e pret zgjidhjen nga LV-ja. "Ne po presim një zgjidhje nga LV-ja. Një zgjidhje që është funksionale për të dyja palët. Derisa ta marrim zgjedhjen po presim. Përgjegjësia është e atyre që të ofrojnë një zgjidhje në këtë situatë të krijuar. Nuk po flas as për ofertën e Kurtit sepse ne nuk e kemi shqyrtuar në organet tona. Ofertat e veçanta nuk i shqyrtojmë. Kemi biseduar për parimet që duhet t'i ketë një qeverisje. Po e presim një zgjidhje që ata duhet ta ofrojnë që të kemi një qeveri stabile", ka thënë Veliu, duke shtuar se për takimin me ambasadorin Kosnett ka qenë

në vazhden e takimeve të rregullta. Zyrtarët e LDK-së nuk kanë treguar se cila është oferta e fundit që ua kanë bërë zyrtarëve të LV-së për bashkëqeverisje. Por, ofertën e LDK-së e kanë bërë publike zyrtarët e LV-së. Anëtari i Këshillit të Përgjithshëm i Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh kryetar i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka thënë për "Epokën e re" se LDK-ja po këmbëngulë që t'i kthehet posti i kryetarit të Kuvendit. "Pasi kemi rifilluar bisedimet ata këmbëngulin që t'u kthehet posti i kryeparlamentarit. Mendoj se ata duhet ta kuptojnë se kjo çështje tashmë ka përfunduar. Kjo kërkesë nuk është në rregull, sepse t'i humbësh zgjedhjet dhe ta kërkoh postin e kryeparlamentarit nuk është e drejtë. Po ashtu, ta kërkoh postin e presi-

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË 13 JANAR** - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett, ka kërkuar të hënën nga udhëheqësit politikë ta formojnë qeverinë e re. Në takimin me krerët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK),

diplomati amerikan ka deklaruar që sa më parë duhet të përmbushet mandati i votuesve. "Kryetari Mustafa e njoftoi ambasadorin Kosnett për rrjedhën e bisedimeve të deritanishme me Lëvizjen Vetëvendosje për arritjen e marrëveshjes për bashkëqeverisje. Ambasadori Kosnett ftoi udhëheqësit politikë ta formojnë qeverinë e re e

cila sa më parë do ta përmbushë mandatin e votuesve", është bërë me dije në njoftimin e LDK-së. Ndërsa pas takimit me ambasadorin amerikan, lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se i takon Lëvizjes Vetëvendosje të bëjë zgjidhje për situatën. "Zgjidhjen për situatën e bën LV-ja, jo ne", ka thënë shkurt

# Presidenca s'e përjashton mundësinë që t'i drejtohet Kushtetueses për punën e mandatarit

Zyra e Presidentit të Kosovës ka bërë m dije se është nën përgjegjësinë e Presidentit funksionalizimi i institu-

cioneve kushtetuese. "Ai është garantues i funksionimit kushtetues e demokratik dhe është i

obliguar të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për ta përmbushur këtë detyrim të tij, duke mos përjashtuar

edhe kërkesat drejtuar Gjykatës Kushtetuese për të sqaruar çdo paqartësi kushtetuese dhe ligjore në

shërbim të funksionalizimit sa më të shpejtë të institucioneve të reja", raporton KTV.

dentit, duke mos përmendur asnjë emër, as kjo nuk është në rregull. Tani bisedimet kanë mbetur te kryeparlamentari", ka thënë Bahtiri.

Ai ka treguar se LV-ja në këmbim të postit të kryeparlamentarit të LDK-së i ka ofruar Ministrinë e Punëve të Jashtme. "Si anëtar i LV-së kam propozuar që si kompensim për postin e kryetarit të Kuvendit t'i jepet LDK-së Ministria e Punëve të Jashtme. Ndërsa kur të zgjedhet presidenti në vitin 2021, MPJ-ja t'i kthehet LV-së dhe të vazhdojmë qeverisjen me nga pesë ministri", ka thënë ai, duke shtuar se ende nuk kanë marrë një përgjigje nga LDK-ja për këtë çështje.

## Kurti i përgjigjet letrës së Thaçit

Disa ditë pasi presidenti i ka kërkuar LV-së emrin e kandidatit për kryeministër, kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka vendosur t'i përgjigjet shefit të shtetit. Në letrën e tij të gjatë, Kurti ka kërkuar nga presidenti Hashim Thaçi që të mos bëjë presion në lidhje me caktimin e mandatarit për postin e kryeministrit. "Kushtetuta e Kosovës nuk i njeh presidentit diskrecion e as rol aktiv në procesin e caktimit të mandatarit apo edhe të garantimit të një shumice parlamentare për zgjedhjen e Qeverisë në Kuvend. Kjo si rrjedhojë e parimit që quhet 'zinxhir i legjitimitetit kushtetues', ku i vetmi organ kushtetues që legjitimohet në mënyrë të drejtë-përdrejtë nga populli është Kuvendi, andaj ndaj të njëjtit mund t'i supozohet ose t'i imponohet shprehja e vullnetit nga një organ tjetër sikur që është Presidenti i Republikës", është thënë në letrën e Kurtit.

Kurti ka thënë më tej se roli i presidentit njihet si ceremonial dhe se Kushtetuta nuk i njeh rol imponues për formimin e qeverisë. "Ai duhet të jetë i durueshëm dhe të presë. Formimi i qeverisë nuk është i lidhur me afate (përjashtimisht pas mandatimit zyrtar të cilin e bën Presidenti pasi t'i jetë ofruar zyrtarisht emri i kandidatit) për shkak se demokracia nuk është thjesht grumbullim numrash, por përaftrim qëndrimesh, harmonizim programesh e bartje përgjegjësish", ka vlerësuar Kurti.

Më tej, lideri i LV-së i ka bërë me dije presidentit se nuk mund ta mandatojë dikë tjetër për kryeministër, përveç kandidatit

të partisë fituese të zgjedhjeve.

"Ne ende nuk jua kemi dërguar juve propozimin tonë për kryeministër. Do ta bëjmë këtë në të ardhmen e afërt, me shkresë zyrtare, porsa të jemi gati. Lëvizja Vetëvendosje! nuk po e shfrytëzon këtë kohë për ta neglizhuar ndërtimin e koalicionit, as edhe ta cenojë autoritetin e Presidentit, por me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje politike që adreson një dakordim për programin qeverisës, zvogëlim të qeverisë dhe reformat e thella që e presin vendin në muajt e vitet në vazhdim. Kjo është një praktikë normale në gjithë botën demokratike. Me këtë rast, shfrytëzoj këtë letër t'ju informoj që ndodhemi në fazën e finalizimit të marrëveshjes me Lidhjen Demokratike të Kosovës", ka përfunduar letrën Kurti.

Më 10 janar presidenti Hashim Thaçi i kishte kërkuar kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, emrin e mandatarit të Vetëvendosjes për postin e kryeministrit, për t'i evituar vonesat rreth formimit të qeverisë së re. "Si president i Republikës së Kosovës jam i obliguar që të ndërmarr veprime pa vonesa të mëtejme, duke ndjekur të gjithë hapat kushtetues që qytetarët e Republikës së Kosovës ta kenë sa më shpejt qeverinë e tyre. Duke marrë parasysh parimet demokratike, transparencën dhe korrektësinë politike, ua kam dhënë mundësinë dhe kam kërkuar në vazhdimësi që ta propozoni kandidatit/en për Kryeministër", kishte shkruar Thaçi, duke përmendur edhe pikën 87 të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, ku thuhet se nuk përjashtohet mundësia që partia ose koalicioni në fjalë do të refuzojë ta marrë mandatin.

Të hënën e kaluar presidenti Hashim Thaçi ka pritur në një takim Albin Kurtin, ku është diskutuar për mandatarin për kryeministër. Më pas, Thaçi i kishte dhënë një afat prej 48 orëve Vetëvendosjes dhe Kurtit për ta propozuar mandatarin. Por, Vetëvendosja e cilësoi afatin e Thaçit si joligjor dhe paralajmëroi se do ta dërgonte emrin e mandatarit së shpejti përmes një letrë.

Caktimi i mandatarit dhe noniminimi i tij nga presidenti ka efekte ligjore pasi që nga ai moment rrjedh edhe afati kushtetues prej 15 ditëve për formimin e Qeverisë së Kosovës.

# Kosova, drejt krizës për ujë të pijshëm

PRISHTINË, 13 JANAR - Për shkak të mungesës së reshjeve atmosferike, përveç Komunës së Gjilanit, edhe qytetarët e Prishtinës dhe të rrethinës mund të ballafaqohen me krizë të ujit të pijshëm, thonë zyrtarët e Ujësllësit Rajonal Prishtina. Sipas autoriteteve kompetente në Prishtinë, aktualisht ka rënie të nivelit të ujit në liqenin e Badovcit dhe të Batllavës, prej të cilëve sigurohet uji i pijshëm për më shumë se 140 mijë konsumatorë.

Ujësllësi Rajonal "Prishtina" është ndërmarrja më e madhe e furnizimit me ujë të pijes në Republikën e Kosovës nga e cila furnizohen me ujë tetë komuna të Kosovës, përfshirë kryeqytetin Prishtinën.

Kryeshefi ekzekutiv i Ujësllësit Rajonal "Prishtina", Ilir Abdullahu, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se nëse vazhdon mungesa e reshjeve, në ditët e ardhshme kompania do të fillojë t'i zbatojë masat e reduktimit. "Nëse nuk ka reshje, rezerva të ujit ka për gjashtë ose shtatë muajt e ardhshëm. Kemi minus rreth 10 metra ujë të pijes në të dy liqenet, Batllavë dhe Badovc. Siç po shihet edhe gjatë kësaj jave mundësitë e reshjeve nuk janë, kështu që ne po futemi në një krizë të ujit në të ardhmen. Edhe pse deri më tani ne kemi mbajtur një furnizim me ujë për 24 orë, tashmë jemi në përpilim të një plani për fillimin e reduktimeve, aty ku mundësitë teknike ekzistojnë, në mënyrë që të menaxhohen nivelet e ujit

që tani për tani i kemi", ka deklaruar Abdullahu. Edhe në Shoqatën e Ujësllësve të Kosovës (ShUKOS) pohojnë se mungesa e reshjeve atmosferike ka ndikuar në zvogëlimin e sasisë së ujit në nivel vendi, por gjendje më e rëndë, sipas kësaj shoqate, paraqitet të jenë në Komunën e Gjilanit.

Komuna e Gjilanit që nga mesi i vitit të kaluar është duke u ballafaquar me mungesë të madhe të rezervave të ujit. Në këtë komunë tashmë janë duke u zbatuar reduktimet.

Muhamed Suliqi, kryetar i bordit të kësaj shoqate, njëherësh kryeshef ekzekutiv në Ujësllësin Rajonal "Hidromorava" në Gjilan, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se për një pjesë të qytetarëve janë duke u zbatuar reduktimet nga ora 21:00 e mbrëmjes deri në orën 6:00 të mëngjesit. "Është duke ndikuar ende thatësira, nuk ka ngritje të nivelit të ujit. Nëse vazhdohet me këtë gjendje thatësie, rrezikohen edhe pusët ekzistuese", është shprehur Suliqi.


Penda e Përlepnicës është burimi kryesor i ujit të pijes në Gjilan, ku furnizohen me ujë të pijes rreth 60 për qind e qytetarëve të Komunës së Gjilanit. Përveç kësaj, ekzistojnë edhe tri burime më të vogla, Gurit të Hoxhës, Banjës dhe puseve në Velekincë. Sasia e reshjeve në disa zona të Kosovës, konkretisht në zonën e Anamoravës (që përbëhet nga Komuna e Gjilanit, e Vitisë dhe e

Kamenicës) vitin e kaluar kanë qenë nën vlerën mesatare të reshjeve që regjistrohen nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, pohojnë udhëheqës të këtij Instituti.

Letafete Latifi, drejtuese e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, tregon për "Radion Evropa e Lirë", se në vitin 2014 në stacionin matës në Përlepnicë sasia e reshjeve ka qenë 856 litra për metër katror, ndërsa vitin e kaluar kjo sasi ka qenë 450 litra për metër katror. Situatë e ngjashme, sipas Latifit, ka qenë edhe në stacionin matës të Batllavës.

Edhe në ditët në vijim nuk parashikohet të ketë reshje atmosferike, tha Latifi. "Këtë javë moti do të jetë i ngjashëm, temperatura minimale do të jetë nga -1 deri në -5 gradë celsius, kurse maksimalja do të arrijë nga 3 deri në 7 gradë celsius. Ndërsa gjatë kësaj jave nuk parashihet të ketë reshje të shiut apo borës", ka deklaruar Latifi.

Aktualisht qytetarët e Kosovës furnizohen nga disa burime natyrore dhe artificiale të ujërave. Liqeni i Ujmanit (Gazivoda) në Zubin Potok, Batallava në Podujevë, Badovci në Prishtinë, Radoniqi në Gjakovë dhe Përlepnica në Gjilan, krahas lumenjve Drini i Bardhë në Rrafshin e Dukagjinit, Ibrit në Mitrovicë, Moravës së Binçës në Anamoravë dhe Lepencit në jug, janë disa prej burimeve kryesore të ujit të pijshëm në Kosovë.



## Begaj kërkon angazhim maksimal nga drejtorët komunalë



**MALISHEVË, 13 JANAR (ER)** - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka mbajtur mbledhjen e parë të Këshillit të Drejtorëve për vitin 2020. Me këtë rast, kryetari Begaj ka uruar që viti 2020 të

jetë një vit i suksesshëm, ndërsa nga drejtorët e drejtorive komunale ka kërkuar punë dhe angazhim maksimal për realizimin e detyrave dhe detyrimeve në bazë të përgjegjësi që i kanë si drejtues të drejtorive

përkatese. "Pavarësisht prej rrethanave politike të krijuara dhe problemeve që mund të dalin si pasojë e këtyre rrethanave, kërkoj nga të gjitha drejtoritë, drejtorët dhe zyrtarët përgjegjës, që të jenë të

angazhuar maksimalisht për realizimin e detyrave", ka thënë Begaj. Ndërkaq drejtorët e drejtorive komunale kanë raportuar për punën dhe angazhimet e tyre, duke përfshirë edhe planifikimet e tyre për vitin 2020.



## Fillon procesi mësimor në të gjitha shkollat e Skenderajt

**SKENDERAJ, 13 JANAR (ER)** - Me rastin e fillimit të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2019-2020, kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka vizituar Shkollën Filllore të Mesme të Ulët "Ahmet Delia" në Skenderaj, për t'iu uruar mesimdhënësve dhe nxënësve suksese në procesin e

mësimdhënies e mesimnxënies. Me udhëheqësit e kësaj shkolle kryetari Jashari ka biseduar për procesin mësimor, për kushtet infrastrukturore si dhe rreth mundësive për ndërtimin e sallës së sportit në këtë shkollë, për të cilën ai ka premtuar se do të angazhohet maksimalisht.



## Komuna e Prizrenit do t'i furnizojë 20 fermerë me centrifuga për nxjerrjen e mjaltit

**PRIZREN, 13 JANAR (ER)** - Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka ftuar të gjithë fermerët e Komunës së Prizrenit që të aplikojnë për thirrjen publike për përfitim në kuadër të projektit "Furnizimi me centrifuga për nxjerrjen e mjaltit". Kjo thirrje vlen për

furnizim të 20 fermerëve me centrifuga për nxjerrje të mjaltit. Komuna e Prizrenit më parë ka shpërndarë edhe 100 centrifuga të tjera për fermerët përfitues. Kriteret që duhet t'i plotësojnë aplikuesit mund t'i gjeni në uebfaqen e Komunës së Prizrenit.

## 12 studentë të rajonit të Dukagjinit përfitojnë punë praktike përmes projektit të 'Anibar'

**GJAKOVË, 13 JANAR (ER)** - "Anibar" ka nënshkruar tri memorandume me kryetarët e komunave Pejë, Gjakovë dhe Deçan, me qëllim të bashkëpunimit në projektin "Të rinjtë për ndryshim", që është projekt me qëllim të përkrahjes së të rinjve në rajonin e Dukagjinit.

Bashkëpunimi në mes të organizatës "Anibar" dhe këtyre tri komunave ka për qëllim krijimin e hapësirave për punë praktike për studentët në komunat përkatëse, ndërsa një prej synimeve është edhe zhvillimi i platformës online për pjesëmarrje aktive të të rinjve në proceset vendimmarrëse.

Përveç këtyre tri komunave, gjatë muajit janar pritet që projektin t'i bashkohen edhe komuna e Klinës, Istogut dhe Junikut. Nga këto marrëveshje, 12 studentë do të përfitojnë punë praktike me pagesë në gjashtë komunat (Pejë, Deçan, Klinë, Istog, Junik dhe Gjakovë) për një periudhë tremujore.



## Bahtiri kërkon zbatimin e ligjit kundër duhanit në të gjitha subjektet afariste

**MITROVICË, 13 JANAR (ER)** - Bordi i drejtorëve në Komunën e Mitrovicës ka mbajtur mbledhjen e radhës në të cilën janë diskutuar disa pika të rendit të ditës, që janë me interes për qytetarët e kësaj komune. Fillimisht drejtori për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Shukri Gashi, ka njoftuar ekzekutivin lidhur me inkasimin e të hyrave vetjake për vitin 2019 në Komunën e Mitrovicës.

Ai ka thënë se krahasuar me vitin 2018 kjo komunë ka pasur rritje



të të hyrave për 15.20 për qind apo 304.189.32 euro më shumë.

"Ndërsa sa i përket planifikimit për vitin 2019, ka arritur t'i

realizojë 93.56 për qind të planifikimit apo ka inkasuar 2.305.615.56 euro, ndërkaq inkasimi i të hyrave vetjake në vitin 2018 ishte 2.001.426.24 euro", ka thënë Gashi.

Ndërsa drejtori i Inspeksionit, Hysni Ahmeti, ka njoftuar bordin lidhur me inspektimet e inspektorëve komunalë për lirimin e hapësirave publike si dhe për inspektimin e subjekteve afariste lidhur me vendimin për respektim të orarit të punës. Po në këtë mbledhje kryetari i Mitrovicës,

Agim Bahtiri, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik të qytetarëve, ka kërkuar nga Drejtoria e Inspeksionit ta zbatojë Ligjin për kontroll duhani nr. 04/L-156 në të gjitha subjektet afariste, në të kundërtën do të merren masa ndëshkuese përmes shqiptimit të gjobave. Në fund drejtori për Arsim, Egzon Jashari, ka thënë se janë bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë në të gjitha institucionet edukativo-arsimore në këtë komunë.

## Konjufca merr urim nga kryetari i Kuvendit të Sllovenisë

PRISHTINË, 13 JANAR (ER) - Kryetari i Kuvendit Kombëtar të Sllovenisë, Dejan Zidan, ka uruar kryeparlamentarin Glauk Konjufca me rastin e zgjedhjes së tij në krye të Kuvendit Republikës së Kosovës. Në telegram thuhet se Republika e Sllovenisë do të vazhdojë ta mbështesë fuqishëm përparimin e Kosovës në procesin e zgjerimit euroatlantik. "Shkëlqesia juaj, në emrin tim personal dhe të

Kuvendit Kombëtar të Republikës së Sllovenisë, më lejoni t'ju përcjell urimet e sinqerta për zgjedhjen në postin e kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Unë jam i bindur që do t'i përkushtoheni përmbyshjes së qëllimeve të caktuara me zgjuarsidhe të bëni përpjekje të mëdha për realizimin e tyre. Ju dëshiroj suksese në kryerjen e përgjegjshme të punës suaj. Me

këtë rast dëshiroj të shpreh sa jam i kënaqur me marrëdhëniet tradicionalisht të mira ndërmjet Republikës së Sllovenisë dhe Republikës së Kosovës. Unë jam i bindur se nëpërmjet një bashkëpunimi aktiv të dy parlamenteve, edhe në të ardhmen do të zhvillohet me sukses kjo marrëdhënie. Njëkohësisht, do të dëshiroja t'ju siguroja se Republika e Sllovenisë do ta vazh-

dojë mbështetjen e fuqishme ndaj përparimit të vendit tuaj në procesin e zgjerimit euroatlantik, dinamika e të cilit është me rëndësi të veçantë në kohën kur jemi duke u ballafaquar me sfidat globale dhe rajonale që janë gjithmonë në rritje. Lidhur me këtë, Kuvendi Kombëtar i Sllovenisë do të jetë gjithmonë i gatshëm për bashkëpunim duke ndarë njohuritë e kërkuara, përvojën dhe



praktikat e mira. Shkëlqesia Juaj, ju lutem më lejoni t'ju dëshiroj sukses, lumturi dhe mirëqenie personale në vitin që sapo ka filluar. Ju lutem pranoni konsideratën time më të lartë", përfundon telegrami i kryetarit të Kuvendit të Sllovenisë.

# Përrurohet CT-ja e re në Spitalin e Gjilanit

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

GJILAN, 13 JANAR - Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Uran Ismaili, së bashku me ambasadorën e Luksemburgut në Kosovë, Natacha Gomes, kanë përruruar të hënën CT-në 128 shtresore në Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit, e cila është e para e këtij lloji në institucionet publike shëndetësore në Kosovë.

CT-ja 128 shtresore në vlerë prej 400 mijë eurosh është donacion

i Qeverisë së Luksemburgut, që përmes programit përkrahës për shëndetësi në Kosovë tani e disa vjet u ka dhënë ndihmë reformave dhe avancimit të shërbimeve shëndetësore.

Ismaili ka uruar profesionistët shëndetësorë të Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit për pajisjet e reja, duke thënë se kjo është në vazhden e modernizimit të sistemit shëndetësor në Kosovë. Ai ka falënderuar edhe Qeverinë e Luksemburgut për mbështetjen e vazhdueshme për shëndetësinë e Kosovës.

"Falënderim i veçantë për Qeverinë e Luksemburgut për ndihmën që na ka ofruar. Kjo ndihmë nuk ndodh vetëm sot, por Luksemburgu me dekada jep ndihmë për Kosovën. Kemi një pajisje e cila është më modernia në Kosovë, e cila i ngrit shërbimet tona që nuk i kemi pasur ndonjëherë këtu në Kosovë dhe të gjitha këto vijnë për qytetarët, që ata të mos presin me javë dhe kjo tregon se modernizimi i spitaleve tona ndihmon qytetarët tanë të mos shpenzojnë para", ka thënë min-

istri Ismaili.

Ambasadorja Natacha Gomes tha se Luksemburgu e ka përkrahur Kosovën tash e 20 vjet dhe kjo pajisje është më e avancuara në Kosovë.

Drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, ka thënë se përfituesit më të mëdhenj do të jenë pacientët. "Një falënderim i madh për Qeverinë e Luksemburgut dhe përfituesit më të mëdhenj janë këtu pacientët dhe një prej hallkave më të rëndësishme është kjo CT dhe do të ngritet niveli profe-

sional i trajtimit të pacientëve", ka thënë ai.

Ndërkaq Nistret Hajrullahu, drejtor i Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit, ka thënë se ky donacion do të ndihmojë për t'u shërbyer pacientëve në kohën e duhur dhe gjithçka këtu është rinovuar dhe në financim ka marrë pjesë edhe ShSKUK dhe komplet kabineti i CT është kompletuar dhe është prej teknologjive më të reja dhe është aparat i parë në spital. Gjithashtu, 100 mijë euro shtesë janë ndarë edhe për pajisje të tjera për këtë spital.

## Hoti u dhuron libra nxënësve fitues të Kamenicës dhe Fushë-Kosovës

PRISHTINË, 13 JANAR - Koordinator Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Kosovës, Rexhep Hoti, i ka dhuruar të hënën 269 sete librash nga autorë të ndryshëm. Librat u janë dhuruar si shpërblim nxënësve fitues të garës Nationale në Kreativitet Kulturor dhe Mendim Kritik dhe garës Nationale të Diturisë në Komunën e Fushë-Kosovës si dhe të Kamenicës. Me këtë rast, koordinatori Hoti ka uruar edhe


fillimin e gjysmëvjetorit të dytë duke thënë se po nis këtë gjysmëvjetor duke shpërblyer nxënësit për suksesin e arritur. Në Kamenicë, Hoti ka theksuar rëndësinë e shkollimit, ndërkohë ka shprehur përkrahje për reformat në arsim, kurse në Fushë-Kosovë ka folur për masivitetin e garave dhe rëndësinë e tyre. Edhe kryetari i Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka folur për rëndësinë e shkollimit dhe të

shpërblimeve që u janë ndarë nxënësve. Nxënësit fitues janë ndarë të kënaqur me shpërblimet, ndërsa kanë treguar edhe për përgatitjet që kanë bërë për garat. Komuna e Kamenicës ka pasur 968 nxënës fitues në të gjitha nivelet e garës nacionale në kreativitet kulturor e mendim kritik si dhe në dituri, ndërsa 530 fitues në të gjitha nivelet e garave ka pasur Komuna e Fushë-Kosovës.



# Debllokada e vullnetit të sovranit

Sjelljeje e pandërgjegjshme e partive fituese, përndryshe, me deklarin e vijave të kuqe për koalicion me tri subjektet e PAN-it që ka qenë në pushtet, nuk lë hapësirë për kombinime të tjera të bërjes së shumicës qeverisëse. Ky edhe është faktori kyç që i ngushton hapësirat manovruese dhe prodhon bllokadën. Me fjalë të tjera, LV-ja dhe LDK-ja do të mund të bisedonin ndaras edhe me partitë e PAN-it që së bashku i kanë 43 deputetë, për qeveri alternative (në bazë të numrave janë dy mundësi: LV+PAN= 72 dhe LDK+PAN=71). Pra, matematikisht këto koalicion do të ishin shumë më "komode" se koalicioni që po negociohet aktualisht (LV+LDK=57) e që do ta bënin qeverinë edhe pa votat e deputetëve të minoriteteve, si dhe me ato edhe 2/3 për vendime kapitale! Në këtë listë të opsioneve të hapura ka edhe kombinime të tjera koalicionesh që japin shumicën.



Shkëlzen MALIQI

Kosova sërish ballafaqohet me bllokadën e vendimmarrjes politike që për pasojë prodhon krizë të zgjatur të qeverisjes. Edhe pse vota e 6 tetorit dukej më e vendosur dhe më e qartë se herëve të tjera ngaqë dy partitë, LV-ja dhe LDK-ja, fituan vota të mjaftueshme për krijimin e një shumicë stabile për qeverisje, nuk doli ashtu, pasi që liderët e tyre nuk po merren vesh për qeverisjen e përbashkët. Albin Kurti dhe Isa Mustafa nuk janë duke i përmbushur pritjet e votuesve, e as premtimet që i jepnin me lehtësi kur besohej se së bashku e kanë siguruar shumicën e ulëseve në Kuvend. Në të vërtetë, nëse në momentin e fundit KQZ-ja nuk do ta konstatojë dhe certifikonte hyrjen e koalicionit Nisma-AKR-PD në Kuvend (me një promil të përqindjes mbi pragun!) dy partitë fituese do të mund ta bënin qeverinë edhe vetë, pa kërkuar vota shtesë deputetësh të partive që ua kishin vënë "vijat e kuqe" për bashkëpunim. Por, edhe me raportin aktual (LV 29 + LDK 28 = 57 deputetë) u evitua varësia nga deputetët e Listës serbe (që e kushtëzonte dhe kufizonte Qeverinë Haradinaj), sepse minusi prej katër deputetësh mund të kompensohet lehtë me deputetët e minoriteteve të tjera. Po, ja që edhe deklarimi i qartë i elektoratit në favor të LV-së dhe LDK-së, deri më sot nuk solli

kompromisin meritator që do ta respektonte vullnetin e shumicës së votuesve shqiptarë. Negociatat po ngecin me javë të tëra edhe pse liderët e këtyre partive premtorin se marrëveshja është çështje ditësh, në mos edhe orësh. Kuptohet, ka ende gjasa që marrëveshja të arrihet përkundër zhargitjeve, por në opinion tashmë mbizotëron zhgënjimi dhe përshtypja se bisedimet nuk po shkojnë drejt kompromiseve pajtimtare, por se po ndodh e kundërta, raportet janë duke u acaruar dhe ngatërruar gjithnjë e më shumë. Në vend se të bëhet kompromisi rreth postit të presidentit, e edhe ndonjë nivelizim real i peshës së posteve ministore dhe të tjera, tani palët sikur janë duke u kthyer në piken zero kur gjithçka po bëhet diskutabile.

Kjo sjelljeje e pandërgjegjshme të partive fituese, përndryshe, me deklarin e vijave të kuqe për koalicion me tri subjektet e PAN-it që ka qenë në pushtet, nuk lë hapësirë për kombinime të tjera të bërjes së shumicës qeverisëse. Ky edhe është faktori kyç që i ngushton hapësirat manovruese dhe prodhon bllokadën. Me fjalë të tjera, LV-ja dhe LDK-ja do të mund të bisedonin ndaras edhe me partitë e PAN-it që së bashku i kanë 43 deputetë, për qeveri alternative (në bazë të numrave janë dy mundësi: LV+PAN= 72 dhe LDK+PAN=71) pra, matematikisht këto koalicion do të ishin shumë më "komode" se koalicioni që po negociohet aktualisht (LV+LDK=57) e që do ta bënin qeverinë edhe pa votat e deputetëve të minoriteteve, si dhe me ato edhe 2/3 për vendime kapitale! Në këtë listë të opsioneve të hapura ka edhe kombinime të tjera koalicionesh

që japin shumicën.

Por, ja që kjo nuk po ndodhë për shkak të interpretimeve të ngurta të Kushtetutës e cila nuk përcakton qartë procedurat në rastet e veçanta kur ndarja e votës krijon vështirësi për krijimin e koalicioneve. Një interpretim i mëhershëm i Gjykatës Kushtetuese e ka fiksuar se e drejta për mandatarin e qeverisë i takon subjektit që ka më së shumti vota në zgjedhjet. Në kohën kur është bërë ky interpretim, që tani është i përligjur si detyrim, më herët ishte favorizuar PANI, kurse aktualisht partia fituese LV-ja. Prej saj pritet që edhe zyrtarisht ta dërgojë emrin e Albin Kurtit te presidenti Hashim Thaçi, në mënyrë që ky ta mandatojë atë për kryeministër. Ka tre muaj që vetë Kurti e edhe të tjerët e shohin atë si kryeministër, por formalizimi nuk ka ndodhur ende, madje nuk po mund të nisat as afati dy javësh sa i jepet kandidatit për kryeministër që t'i mbledh votat e përkrahjes për zgjedhjen e tij në Kuvend. Për më shumë, Kushtetuta nuk e përcakton qartë (ose interpretimet rreth kësaj janë të ndryshme edhe nga ekspertët), as procedurën dhe kompetencat e presidentit në rast se dështon mandatarin i parë. Në rastin konkret shtrohet pyetja si do të procedohet nëse Albin Kurti nuk i siguron votat e shumicës dhe e kthen mandatin? Ose edhe del para Kuvendit dhe nuk e voton shumica. A e ka të drejtë presidenti që ta mandatojë ndonjë kandidat të radhës dhe nga cili subjekt? Disa thonë duhet të jetë nga subjekti i njëjtë fitues, disa e lënë të hapur, që Presidenti ta vlerësojë se cili subjekt dhe cili prej liderëve ka më shumë gjasa të sigurojë përkrahjen e minimumit prej 61 deputetëve.

Pasi që kushtetuta nuk i detalizon procedurat për situatat komplekse që krijohen në praktikë, do të duhej që ajo të plotësohej ose të përcaktohet me ligj të veçantë.

Ajo që determinon problemin aktual e konstituimit të qeverisë dhe zgjedhjen e kryeministrit, është reduktimi artificial i vullnetit të elektoratit në dy fitues që nuk e kanë shumicën automatike të kontrollit të pushtetit, dhe që deri më sot nuk kanë qenë në gjendje ta bëjnë as koalicionin e mangët me 57 deputetë, ku pastaj do të mund t'i kërkonin edhe votat shtesë nga deputetët e partive të tjera, zakonisht të partive minoritare, por mund të jetë edhe ndonjë "pehllivan" nga partitë humbëse të zgjedhjeve, siç ka ndodhë më herët.

Kur e them se po bëhet reduktimi i vullnetit të elektoratit e kam parasysh se aktualisht të gjitha

opsionet e pushtetit lidhen me LV-në dhe LDK-në, ndërkaq që Kuvendi i ri si tërësi, ka ende edhe disa opsione të tjera, edhe pse vetëm matematikore dhe teorike, për krijimin e koalicioneve alternative, që formalisht nuk do të ishin aspak më legjitime se koalicioni LV me LDK-në.

Por, pyetja që shtrohet këtu është, çka nëse Albin Kurti dhe Isa Mustafa nuk e bëjnë qeverinë, a duhet të shkohet detyrimisht në zgjedhje të reja? Mendoj se në rast të dështimit presidenti e ka për detyrë ta hap rrugën për alternative të tjera të koalicioneve, nga kushdo që ia sjell minimumin e 61 nënshkrime se mund ta bëjë qeverinë. Gjithsesi janë gjasat e mëdha që kjo tentativë do të dështonte, por përgjegjësitë që i ka ai si president e detyrojnë që t'i shtjerr të gjitha mundësitë që i jep vullneti i tërësishëm i votës së 6 tetorit, që nuk mund të jetë pronë ekskluzive e fituesve relativë, që në këtë rast së bashku i kanë 57 deputetëve, gjithsesi më shumë se 43 deputetët e ish PAN-it, por që më 6 tetor kanë garuar ndaras dhe në parim nuk mund t'iu mohohet e drejta për participim në qeverisje, nëse ka mandatar që i fton për koalicion alternativ.

Mirëpo, përparësia e fituesve relativë bëhet e llogaritshme dhe e vlefshme vetëm nëse LV-ja dhe LDK-ja e pajtojnë koalicionin, dhe jo nëse nuk merren vesh dhe duan që vendin ta çojnë sërish në zgjedhje. Në atë rast nuk duhet të bllokohen tërësisht alternativat për koalicion të tjera, por i lihet mundësia krijimit të cilësdo shumicë të deputetëve, pa paragjykuar orientimet dhe "vijat e kuqe" të mosbashkëpunimeve mes tyre. Mendoj se presidenti i Kosovës, jo si Hashim Thaçi por si simbol dhe mbrojtës i unitetit të vendit dhe figurë parimisht mbipartiake, duhet ta ketë të drejtën e diskrecionit për caktimin e një mandatarit të dytë, nëse dështon i pari.

Kushtetuta e Kosovës nuk i ka detalizuar procedurat e situatave diskutabile të mundshme, p. sh. nëse raporti mes LV-së dhe LDK-së do të ishte jo si më 6 tetor 29:28, por ajo e barazisë së plotë, p. sh. që të dy partitë të fitonin nga 29 deputetë. Kjo nuk përjashtohet, apo jo? Bile, ka mundur të ndodh edhe më 6 tetor. Në atë rast ndoshta do të duhej t'i jepej përparësia subjektit që ka fituar qoftë edhe 1 votë më shumë se subjekti tjetër, vetëm se edhe kjo do të duhej të përligjej si e tillë në formë rregullash të shkruara.

Por ajo për çka besoj se duhet të reflektohet lidhur me situatën e krijuar është se pas çdo rezultati të zgjedhjeve pikënisja duhet të

jetë tërësia e elektoratit, sepse vetëm tërësia e votuesve përben sovranin legjitimues të zgjedhjeve. Andaj unë flas për fituesit relativë dhe jo absolut të zgjedhjeve, që disa madje e ngatërrojnë edhe te raporti mes LV-së dhe LDK-së, kur subjekti e parë e konsiderojnë bartës të vullnetit të popullit dhe sovranit. Jo, nuk e përfaqëson LV-ja vullnetin i sovranit por vetëm pak më shumë se një të katërtën e këtij vullneti, dhe as me LDK-në së bashku nuk e përbëjnë vullnetin e shumicës, por ndalen te 57 deputetë së bashku, dhe u duhen "patericat" e ftesës për subjektet e tjera që ta bëjnë qeverinë.

Në rast se LV-ja dhe LDK-ja nuk arrijnë marrëveshjen dhe duan që ta çojnë vendin në zgjedhje të reja të parakohshme, presidenti do të duhej ta kishte të drejtën diskrecionale të fillojë konsultat me të gjitha subjektet politike parlamentare për ta kërkuar kandidatit eventual alternativ që ia garanton mbledhjen e shumicës prej minimum 61 deputetëve. Vetëm nëse LV-ja dhe LDK-ja, edhe pas konsultave shtesë, deklarohen se nuk pranojnë të bëjnë koalicion me partitë e ish PAN-it, plus partitë e minoriteteve, atëherë do të detyrohej t'i shpall zgjedhjet e reja. Megjithatë, mendoj se presidenti do të duhej të kishte edhe të drejtën për kërkimin e një alternative të tretë, që të evitohen zgjedhjet në afatet e shkurtra siç e përcakton ligji, duke u konsultuar për një kryeministër dhe qeveri teknike me mandat të kufizuar, brenda termeve dhe afateve me të cilat do të pajtohej shumica e subjekteve politike.

Një gjë tjetër me rëndësi që do të duhej të shqyrtohej në përpjekjet për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe avancimit të sistemit tonë parlamentar është shqyrtimi i mundësisë së rritjes së numrit të deputetëve që zgjedhën me votën e qytetarëve jashtë kuotave të rezervuara për deputetet e minoriteteve, që aktualisht është 100:20 (83.3 për qind me 16.7 për qind) me një raport më përfaqësues për strukturën e popullsisë së Kosovës. Kuvendit të Kosovës do të mund t'i shtoheshin të paktën edhe 20 ose 30 deputetë, prej të cilëve 18 ose 28 do të ishin përfaqësues të shumicës, kurse 2 të komuniteteve të minoriteteve që ende nuk janë kategori kushtetuese (minoriteti malazezë dhe kroat) dhe ku proporcioni edhe më tej do të mbetej më i favorshëm për minoritetet në krahasim me përbërjen e popullsisë: në rastin e parë, nëse Kuvendi do të kishte 140 deputetë, ky raport do të ishte 84.3 për qind: 15.7 për qind, kurse në Kuvendin me 150 deputetë raporti do të ishte 85.3 për qind me 14.7 për qind.



# MF-ja: Nëse nuk miratohet Ligji për buxhetin, nga 28 shkurti nuk mund të bëhet asnjë pagesë

Ministria e Financave ka paralajmëruar se në rast të mosmiratimit të ligjit të ri për buxhetin nga Qeveria e re dhe Kuvendi, të gjitha pagesat, duke përfshirë pagat që nga organet e sigurisë e deri te shërbimi civil, pensionet dhe asistencat e tjera sociale, shërbimet publike si dhe të gjitha obligimet e tjera buxhetore do të ndërpriten nga 28 shkurti, përkatësisht 31 marsi nëse ka vendim nga Kuvendi

**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 JANAR - Ministria e Financave ka njoftuar të hënën se në përputhje me kërkesat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi (LMFPP), Neni 22 (par. 1), pas procesit të zakonshëm të pranimit të kërkesave buxhetore, në pajtim edhe me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, më datën 31 tetor 2019 ka dorëzuar në Qeveri propozimbuxhetin për

vitin 2020. "Për shkaqe të njohura politike dhe ligjore Qeveria nuk ka mundur ta aprovojë projektligjin e buxhetit dhe ta dërgojë në Kuvend për shkak se Kuvendi nuk ka ekzistuar. Ky propozimbuxhet mund të trajtohet dhe procedohet nga Qeveria e re te Kuvendi i konstituuar, si organe të nxjerra nga zgjedhjet e fundit parlamentare", është thënë në sqarimin e MF-së.

Në pajtim me autorizimet ligjore të LMFPP-së, Ministria e Financave ka bërë zgjatjen e

ndarjeve buxhetore dhe alokimin e tij për organizatat buxhetore, për dy muaj të vitit 2020, ose 16.67 për qind e ndarjeve finale vjetore të vitit 2019, përkatësisht deri më 28 shkurt 2020, pasi është plotësuar kushti sipas nenit 24, paragrafi 1a i LMFPP-së, përkatësisht për shkak se zgjedhjet janë mbajtur në katër muajt e fundit para fillimit të vitit fiskal, si situatë e përcaktuar në LMFPP. "Në pajtim me nenin 24, paragrafi 2 i LMFPP, vetëm Kuvendi mund të vendosë për zgjatjen e ndarjeve buxhetore edhe për një muaj, përkatësisht për periudhën deri më 31 mars 2020. Kjo është koha përfundimtare e lejuar për shpenzim buxheti dhe nuk ka asnjë instrument tjetër ligjor që ndarjet buxhetore të shtyhen më shumë se tre muaj, pra jo më vonë se data 31 mars 2020. Pas kalimit të afateve të lartpërmendura (28 shkurt, përkatësisht 31 mars), sipas kufizimeve të LMFPP-së, përkatësisht nenit 24, paragrafi

3, nëse ndarjet e lartpërmendura kanë skaduar dhe ligji i ri për ndarjet buxhetore nuk është miratuar, atëherë asnjë organizatë buxhetore ose autoritet tjetër publik nuk mund të autorizojë asnjë shpenzim ose pagesë derisa të miratohet ligji i ri për ndarjet buxhetore. Megjithatë, Ministria dhe Thesari janë të autorizuar që të bëjnë pagesa për larjen e një borxhi publik i cili është marrë në mënyrë të ligjshme sipas pjesës IX të këtij ligji, në kohën kur ato pagesa maturohen", është bërë me dije në njoftimin e kësaj ministrie. MF-ja ka shtuar se në situatën kur nuk miratohet ligji i ri për buxhetin nga Qeveria e re dhe Kuvendi, të gjitha pagesat, duke përfshirë pagat që nga organet e sigurisë e deri te shërbimi civil, pensionet dhe asistencat e tjera sociale, shërbimet publike si dhe të gjitha obligimet e tjera buxhetore do të ndërpriten nga 28 shkurti, përkatësisht 31 marsi (nëse ka

vendim nga Kuvendi) dhe nga Thesari i Kosovës do të lejohen vetëm pagesat për borxhin publik mund të realizohen sipas afatit të pagesës, në pajtim me LMFPP, neni 24, paragrafi 3. "Sipas praktikës parlamentare dhe opinioneve ligjore kompetente, duke qenë se Qeveria në dorëheqje nuk aprovon projektligje dhe, më tepër, projektligjin e buxhetit i cili, përveç të tjerash, është edhe dokument politik i cili pasqyron objektivat strategjike dhe programin e qeverisë, mbetet në përgjegjësi të institucioneve të dala nga zgjedhjet e vitit 2019 që ta mundësojnë konstituimin e organeve të Kuvendit (komisioneve parlamentare) si dhe Qeverisë, për ta trajtuar çështjen e buxhetit dhe projektligjin e buxhetit për vitin 2020, si ndër veprimet e para më se urgjente, propozimin e të cilit si draft e ka dorëzuar Ministria e Financave në arkivin e Qeverisë", është thënë në sqarimin e MF-së.



## Inspektorati i MTI-së konfiskon mallra të falsifikuara

PRISHTINË, 13 JANAR - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka marrë një aksion të konfiskimit të mallrave të falsifikuara që nuk kanë prejardhje dhe mbulesë të faturave.

Kryeinspektori i MTI-së, Lulzim

Syla, ka thënë se ky aksion do të vazhdojë edhe në ditët e tjera bashkë me Doganën dhe Policinë. "Aksioni do të vazhdojë në tërë Kosovën dhe do të konfiskohen mallrat që nuk kanë mbulesë të faturave dhe

janë marka të falsifikuara", ka thënë Syla.

Këtë aksion është duke e monitoruar kryeinspektori Lulzim Syla, i cili ka kërkuar nga komunat që ta mbështesin këtë aksion.



# KOALICIONI LV-LDK BESOJ SE DO TË BËHET, POR... POR, A DO TË JETË VËRTET I SHPRESËS?!



**Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA**

Lehtësisht e parashikueshme, vështirë e realizueshme: Para zgjedhjeve të 6 nëntorit 2019 në një intervistë në "Epoka e re" pata deklaruar se më vështirë do të jetë të bëhet koalicioni LV-LDK pas zgjedhjeve se ai para zgjedhjeve. Ishte një eufori parazgjedhore midis këtyre dy subjekteve se do ta luftojnë korrupsionin, se do ta çkapnin shtetin e kapur, se do të luftojnë për shtet e jo për pushtet, se do të bëjnë reforma të thella në arsim, shëndetësi, ekonomi e sidomos se do ta dekriminalizojnë Ministrinë për Punë të Jashtme e udhëhequr nga një kalkulant i berëzës politike që këtë ministri dhe diplomacinë e ka shndërruar në qerthull të një prostitucioni primitiv dhe servis për baraspeshime politike. Ishte një ofertë, më shumë e natyrës emocionale, se do të bisedohet për çështjen e të pagjeturve, plagë kjo që ende nuk është mbyllur dhe prodhon dhimbje dhe vuajtje, për fat të keq vetëm për familjarët e të pagjeturve, për faktin se ka filluar të harrohet nga të tjerët. Pati premtime edhe për kompensim të dëmeve të luftës e që nuk ka gjasa të realizohet për faktin se asnjë shtet, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, pavarësisht përgjegjësisë konkrete, nuk ka kompensuar palën e dëmtuar porse vetë shteto, në rastin konkret Kosova, i ka kompensuar deri më tani qytetarët e Kosovës që kanë qenë viktimë e gjenocidit nga ish-Jugosllavia dhe Serbia e Aleksandar (Vuçiqit) dhe (Sllobodan) Millosheviqit. Këto ishin tema të patrajtuara në masë të duhur nga qeveritë e mëparshme dhe, duhet pranuar se, përveç se tingëllojnë bukur për veshin e dëgjuarit, kanë të bëjnë edhe me

krenarinë kombëtare. Ishte një disponim konsensual se duhet të ndodhin ndryshime andaj personazhi kryesor i këtyre ndryshimeve llogaritej Albin Kurti, i cili, deri më tani, kryesisht e kishte provuar dhunën e shtetit e jo mundësinë tjetër. Albin Kurti e njeh fort mirë tabelën e shumëzimit si dhe ekuacionet me shumë të panjohura, prandaj u përcaktua për "martesë" me LDK-në, e cila në jo shumë pak raste u dëshmuar të jetë një kurtizane e sofistikuar politike duke i ndërruar të gjithë partnerët në shtratin qeverisës dhe duke deklaruar se, pas të gjithave, ka dalë e paprekur duke e ruajtur "virgjërinë politike" e që, realisht, askush nuk e beson këtë. Këto dy subjekte politike e kishin përkrahjen e madhe si brenda vendit, të diasporës ashtu edhe të faktorit ndërkombëtar, i cili bën çka të dojë në Kosovë, që nga përcaktimi i menysë në zinxhirin e restoranteve prestigjioze, "Te Nazi" ashtu edhe te përcaktimi i rendit të ditës të çdo subjekti politik apo institucioni në Kosovë, qoftë ai në nivel të lagjes e deri tek institucionet më të larta të vendit. Për herë të parë faktori ndërkombëtar ishte 100 për qind kundër krahut të luftës dhe 100 për qind për "Koalicionin e shpresës???". Për herë të parë në Kosovë ishte një opozitë konstruktive që nuk e lakmonte pushtetin dhe që menjëherë i pranoi rezultatet e zgjedhjeve duke u deklaruar si opozitë dhe duke refuzuar në të gjitha mundësitë pjesëmarrjen në pushtetin e ardhshëm, hiç këtu koalicionin që mbijeto i infuzion, Nisma-AKR, që u ofrua për pushtet e që vendosmërisht u refuzua nga LV-ja, në ndërkohë që LDK-ja mbajti qëndrim oportunist. Për herë të parë pozita e ardhshme nuk pati problem me opozitën, por pati dhe ka problem me partnerin e shtratit, apo më mirë ta them, grazhdit të pushtetit dhe tërë lufta po bëhet se kush do ta ketë një thes me taxhi (post) më shumë! Askush, madje as dyshuesit më të mëdhenj nuk kanë besuar se do të kalojnë tre muaj nga përfundimi i zgjedhjeve, pa kurorëzim të

"dashurisë" midis partnerëve që duan të lidhen. Pse e kemi këtë mosmarrëveshje Rregullat e Albinut e forcuan LDK-në: Albin Kurti ishte fitues i zgjedhjeve të 6 tetorit dhe nuk ka rëndësi se a ishte fitues absolut apo relativ për faktin se me Ligjin zgjedhor në fuqi është e pamundur që një subjekt politik ta fitojë shumicën absolute në Kosovë. Gjithashtu, është e qartë se në çdo vend të botës fituesi përcakton dhe i cakton rregullat e lojës e pse këtë të drejtë të mos e ketë Albin Kurti dhe LV-ja?! Në politikë, por edhe në jetën e përditshme, ai që mban qëndrim përjashtues nuk siguron qëndrueshmëri e as bashkëpunim, si kusht elementar i qëndrueshmërisë. Albin Kurti, si frontmen i LV-së, vuri vijat e kuqe për të gjitha subjek-

tet politike në Kosovë (PDK, AAK, NISMA-AKR dhe Lista Serbe), ndërsa ofroi dashuri dhe ngrohtësi politike vetëm për LDK-në dhe pakicat joserbe. Në këtë mënyrë jashtëzakonisht shumë e fuqizoi LDK-së duke krijuar monopol të dashurisë politike, në ndërkohë që u detyrua të sigurojë një përkujdesje kushtetuese për LS-në pasi ia bënë të qartë ambasadorët e shteteve të huaja në Kosovë, se pa Listën Serbe në Kosovë nuk ka jetë politike, nuk të ngrohë dielli dhe nuk ta ndriçon natën as hëna! E tash, midis një LS-je dhe partive të krahut të luftës, të përcaktoheni për LS-në dhe të injoroni një të kaluar të lavdishme dhe një të tashme, më pak të lavdishme siç është krahu i luftës, besoj se edhe për talibanët e Afganistanit

do të ishte një situatë jonormale e lëre më për LV-në që, së paku biologjia dhe anatomia politike, i bënë pjesë të krahut të luftës! Është e vërtetë se një pjesë e krahut të luftës ka hyrë thellë lakrave, mirëpo është një e vërtetë edhe më e madhe, se LDK-ja asnjëherë nuk ka dalë nga lakrat, në të gjitha sistemet dhe në të gjitha përbërjet qeveritare. Albin Kurti tërë kohën pas përfundimit të zgjedhjeve ka qenë kryeministër, pa zyrë dhe pa kapacitetin zbatimi të këtij mandati. Ndërkombëtarët e kanë pranuar si kryeministër në ardhje, Serbia nuk e ka kundërshtuar, por se është frikësuar nga fenomeni Kurti. Përveç gabimit të vijave të kuqe ndaj krahut të luftës dhe hapjen e parajsës politike për LDK-në, Albini ka bërë një gabim sepse e ka demonstruar një karshillëk ndaj politikaneve të Shqipërisë e që ka krijuar një mjedis krejtësisht jotolerant dhe jobashkëpunues. Gabimi i radhës i Albinut ka qenë nënçmimi i kapacitetit negociues të Isa Mustafës, një ujku të moçëm të politikës së Brozit, tash i shndërruar në një dhel për shumë dinake që po përpiqet (me shumë sukses të gjuajë sa më shumë pula - poste) për subjektin politik të cilin e ka drejtuar me shumë mjeshtri, sidomos kohëve të fundit kur LDK-së i parashikonin fatin e Titanikut! Sipas mendimit tim, sot në Kosovë politikani më i fuqishëm dhe më spirituoz është pikërisht Isa Mustafa i cili, me mjeshtri të një filigranisti e shpëtoi LDK-në nga çarja e madhe e që dukej e pashmangshme kurse tani, nga një humbës i madh, del të jetë një fitues i madh për faktin që edhe vetë Albin deklaroi publikisht se pa LDK-në (më saktësisht pa Isa Mustafën) nuk bëhet dot kryeministër! Një e thënë e vërtetë e Albinut e që e ka burimin te rregullat përjashtuese të Albinut që nuk shoh "dashuri" tjetër politike përveç LDK-së. Sot LDK-ja është në situatë të kërkojë çka të dojë nga LV-ja e që dikush mund ta quajë edhe shantazh. Por çfarë rëndësie ka ky formulim i cili, sidomos në Ballkan, është i legalizuar, i lejuar dhe konsideroheni budal-



la dhe leshko nëse nuk e shfrytëzoni rastin: "Kur ju vjen vera kah dera...". LDK-ja ka karta të fuqishme negociimi dhe xhoklerin kryesor e ka shantazhimin me postin e kryeministrit. Deri më tani intervenimi i ndërkom-bëtarëve nuk ka lënë ndonjë gjurmë në lëkurën prej elefanti të LDK-së. Madje as haxhi politik te Grenelli në Gjermani duket se nuk ka ndikuar te LDK-ja, kurse tani edhe një pensionist, që kur nuk ka çka të bëjë vjen në Kosovë dhe i mban ligjëratat Albin Kurti se si duhet të veprjë politikisht, si kusht për t'u liruar nga burgu, si Brad Pitti ka marrë përsipër një mision të pamundur, për ta bindur LDK-në të bëhet më konstruktive në kohën kur Isa Mustafa për Walkerin është Duejn Xhonsoni politik!

Molla e Adamit apo molla e Glaukut: Pas zgjedhjeve duket se ishin ndarë postet; LV-ja postin e kryeministrit e që i takon, edhe sipas rezultatit të zgjedhjeve, edhe sipas Ligjit të Hamurabit, 5 ministri dhe një zëvendëskryeministër, kurse LDK-ja postin e kryetarit të Kuvendit, 5 ministri, një zëvendëskryeministër e që ishte ndarje kryesisht korrekte midis partnerëve që nuk kanë asgjë të përbashkët përveç luftës për pushtet në një vend ku thuaja nuk ka shtet! Në ndërkohë, apetiti i LDK-së u rrit dukshëm dhe në menynë e propozuar, si delikatesë e propozoi edhe postin e presidentit në kohën

kur Hashim Thaçit - Shimës i kalon mandati kushtetues. Pritja një vit e gjysmë për ta marrë postin e rezervuar të presidentit me një projekt të kapjes tipike të shtetit në procesin e çkapjes së premtuar nuk i dallon aspak nga subjektet e tjera. Realisht, këta që e duan "lëkurën presidenciale të Shimës" nuk llogarisin një kohë aq të gjatë, shpresojnë se Gjykata Speciale do ta përshpejtojë këtë proces të "kapjes" së shtetit duke lehtësuar kapjen e re, si model tashmë të etabluar të qeverisjes në Kosovë! Në ndërkohë pati zhvillime "dramatike", Glauk Konjufca u zgjodh në mënyrë shumë demokratike kryetar i Kuvendit. Pas votave të LV-së për Glaukun, për votim demokratik u shqua LDK-ja, që thuaja unanimisht votoi për Glauk Konjufcën duke menduar se do ta përdorë si kartë të fuqishme në negociatat e ardhshme me LV-në. Tash, duke e hëngër fjalën (votën) e tyre, po kërkojnë rikthimin e këtij posti meqë, sipas marrëveshjes së mëhershme, ky post qenka rezervuar për Vjosa Osmanin! Absolutisht nuk kanë të drejtë dhe, nëse LV-ja bën rikthim, duke e detyruar Glaukun të jap dorëheqje, LV-ja, përkatësisht Albini, do të identifikoheshin me kryetuxharin dhe kryekapësin e shtetit ku, Gjat Macolli apo grofi Minhauzen kosovar do të mbetej si sinonim i shembulltyrës, korrektësisë dhe ndershmërisë. LDK-ja, e ardhur në situatë kur: "Vetë

pordhë dhe vetë trembet..." nuk duhet më fare të bisedojë për postin e kryetarit të Kuvendit që tashmë është legjitim dhe i udhëhequr nga një politikan dhe deputet jashtëzakonisht i përgjegjshëm dhe kompetent! Nëse është e vërtetë se LV-ja i ofron 6 ministri LDK-së, një ministri më shumë në këmbim të postit të kryetarit të Kuvendit, konsideroj se është një ofertë shumë bujare e cila nuk do të duhej të refuzohej nga LDK-ja. Nëse LDK-ja qenka hatruar pse LV-ja i ka bërë publike emrat e ministrave, pjesë e kabinetit qeveritar nga LV-ja i bie sikur nëse LDK-ja, përkatësisht Isa Mustafa, e preferon fasulen për drekë, kurse LV-ja i preferon lakrat! Askush nuk e ka ndaluar LDK-në t'i propozojë emrat e ministrave (afërsisht dihen kush do të jenë), edhe pa një marrëveshje të nënshkruar! Për mua shumë më i rëndësishëm është posti i ministrit të Punëve të Jashtme se posti i kryetarit të Kuvendit. Realisht, kryetari i Kuvendit ka përparësi veten në aspektin material sepse ka siguri të përhershme ekonomike përmes përfitimeve të përjetshme që ia garanton Kushtetuta e Kosovës!

Shtrohet pyetja se sa do të jetë efikase qeverisja LV dhe LDK për faktin se besoj se koalicioni do të përfundojë, me hatër a me zor, me një marrëveshje e cila, gjithashtu, besoj se nuk do të vonohet? Nëse LDK-ja i mban ministritë hipotetike, e që ka të

ngjarë të jenë reale, për faktin se Albini i ka ndarë ministritë e tij duke i bërë publike, atëherë do të ketë shumë probleme në jetësimin e programit qeverisës i cili kushtëzohet nga shumë pengesa siç janë: a do t'i kontrollojë kryeministri Kurti edhe ministrat e LDK-së apo vetëm të LV-së dhe pakicave joserbe për faktin se LS-në nuk do ta kontrollojë për aq kohë sa Marko Gjuriqi të jetë gjallë! Nëse lideri i partive të koalicionit do ta ketë fuqinë e kryeministrit për ministrat nga radhët e subjektit që e drejton atëherë del se LDK-ja do të jetë forcë shumicë në qeverinë e ardhshme, kurse LV-ja, minoritet politik për faktin se deputetët e pakicave joserbe dhe të LS-së më lehtë përshtaten në gjirin e LDK-së, sidomos në çastet kur hahet fasulja, jo kokërr me kokërr, por me lugë të madhe të pushtetit! Nëse LDK-ja do ta ketë Ministrinë për Punë të Brendshme atëherë Albulena Haxhiu, si ministre e ardhshme e Drejtësisë, reformat në fushën e drejtësisë do t'i bëjë sipas stilit të ikebanas japoneze dhe për nevojë ekskluzivisht të brendshme! Uroj të jem parashikues i gabuar dhe jo t'ia qëlloj në çdo 10 vjet siç e bën Milaimi! Qeveria në ardhje e ka të kurdisur bombën sociale, detonatorin e së cilës e ka në duar, kamikazi kryesor në botë, më i vlerësuar dhe më i rrezikshmi, kingu i SBASHK-ut, Mon Jasharaj! Pritshmëritë e qytetarëve (për


shkak të vonësës së arritjes së marrëveshje pakëz janë zbehur) ishin të mëdha, prandaj edhe zhgënjimi dhe reagimi është në proporcion me këto pritje. Ndërkaq, problemi më i madh dhe, ma merr mendjen për Albinin dhe LV-në është i pakapërcyeshëm, janë bisedimet me Serbinë, fleksibiliteti i kërkuar për Kosovën (ulje e kurrit deri në nënshtrim) që, për rrethanat tona, e ka fuqinë shkatërruese të reaktorit nuklear të Çernobilit!

Albin Kurti, me një kaligrafi shprehesh po përpiqet të luaj tope me presidentin aktual, Shkëlqesinë e Tij, Hashim Thaçi - Shimen, duke i dërguar letra sikur në kohën e Buharinit. Dua ta përkujtoj Albinin se nuk janë të rrezikshëm ata që lexojnë, qoftë letra e lere më ndonjë roman, por janë shumë të rrezikshëm pikërisht ata që nuk lexojnë fare dhe kam informata se Shima nuk e lexon asnjë letër të Albinin. Shima i ka disa këshilltarë, tradhtarë dhe zuzarë (sepse për të ndershmërit dhe patriotët e vërtetë nuk ka vend aty) të cilët, letrat e Albinin i kanë shndërruar në gazeta muri sikur daci - baot në Kinë ku, njeri lexon, kurse të tjerët dëgjojnë.

Përsëri po e them se marrëveshja do të ndodhë mirëpo, së paku deri më tani, që të dy partnerët nuk janë treguar si çkapës të shtetit, por janë më kapës se kapësit e mëparshëm sepse po luftojnë për çdo post, mbase për interes të qytetarit dhe të shtetit!

## Lapidar për masakrën në burgun e Dubravës

ISTOG, 13 JANAR (ER) - Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK) ka njoftuar se është në proces të realizimit të projektit "Lapidari i Masakrës së Dubravës", në burgun e Dubravës në Istog. "Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës është në proces të realizimit të projektit 'Lapidari i Masakrës së Dubravës', në burgun e Dubravës, Istog. Ne si agjenci kemi një listë me emrat e të burgosurve të vvarë, të plagosur dhe të mbijetuar. Mirëpo, për korrektësi kërkojmë nga të gjithë ata që kanë njohuri për këtë masakër dhe posaçërisht nga të mbijetuarit e kësaj masakre, ta shikojnë listën e publikuar në 'Facebook', te faqja e AMKMK, dhe nëse kanë emra të tjerë që nuk janë përfshirë në këtë listë, të na drejtohen neve si agjenci", është bërë me dije në njoftimin e AMKMK-së.



## Cory Booker heq dorë nga gara për president të ShBA-së

UASHINGTON, 13 JANAR - Kandidati demokrat për president të Shteteve të Bashkuara, Cory Booker ka njoftuar se do t'i japë fund fushatës pas rezultateve dëshpëruese nëpër sondazhe. Senatori nga Nju Xhersi ka dështuar që të kualifikohet

për debatin e ardhshëm mes demokratëve që do të mbahet në Ajova sot (e martë). Booker është konsideruar si yll në rritje në partinë e tij, mirëpo nuk ka arritur të fitojë mbështetje të mjaftueshme. Aktualisht 12 demokratë janë duke garuar për të fituar pozitën e presidentit në Shtëpinë

e Bardhë. "Sot jam duke pezulluar fushatën time për president me të njëjtin frymë që e kam nisur", ka thënë ai në një video, teksa ka njoftuar për dhënien fund të fushatës. Zgjedhjet për president të ShBA-së do të mbahen në nëntor të këtij viti.



# Tensione të larta në Iran pas rrëzimit të avionit ukrainas

Protestat janë zhvillimi i fundit në kohën e tensioneve më të larta midis Iranit dhe Shteteve të Bashkuara që nga Revolucioni Islamik i vitit 1979, kurse videot në mediat sociale, të postuara të dielën vonë regjistruan të shtëna me armë në afërsi të protestave në Sheshin Azadi të Teheranit

TEHERAN, 13 JANAR - Policia në Iran tha të hënën se nuk i ka qëlluar protestuesit që kanë dalë në rrugë qëkur Teherani ka pranuar të shtunën se ka rrëzuar një aeroplan ukrainas të pasagjerëve. Videot e postuara në mediat sociale, megjithatë, kanë treguar

pamje të të shtënave dhe të njerëzve me gjak. Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, përmes një postimi në Twitter, i porositi autoritetet iraniane që "të mos vrasin protestues". Zëdhënësi i Qeverisë iraniane, Ali

Rabiei, u përgjigj, duke thënë se Trumpi derdh "lot krokodili" kur shpreh shqetësim për iranianët. Protestat janë zhvillimi i fundit në kohën e tensioneve më të larta midis Iranit dhe Shteteve të Bashkuara që nga Revolucioni Islamik i vitit 1979. Teherani ka pranuar se ka rrëzuar gabimisht avionin e Ukrainës, duke vrarë të 176 njerëzit në bord. Tragjedia ka ndodhur vetëm pak orë pasi Irani ka sulmuar me raketa bazat amerikane në Irak, në shenjë hakmarrjeje për vrasjen e komandantit iranian, Qasem Soleimani, në një sulm të SHBA-së, më 3 janar.

Publiku iranian shpërtheu në protesta të shtunën, pasi autoritetet pranuan se kanë rrëzuar avionin. Protestat vazhduan edhe të dielën në disa qytete të Iranit. Videot në mediat sociale, të postuara të dielën vonë regjistruan të shtëna me armë në afërsi të protestave në Sheshin Azadi të Teheranit. Pamjet treguan gjak dhe të plagosur që barteshin me makina. "Udhëheqësi ynë është skandaloz dhe budalla", thirri një protestues, duke aluduar në liderin suprem të Iranit, Ajatollah Ali Khamenei.

Të tjera video tregonin policinë duke i goditur protestuesit me shkopinj, ndërsa njerëzit pranë bërtisnin: "Mos i rrihni", raporton Reuters, njofton rfe. Agjencia e lajmeve, megjithatë, thotë se nuk ka mundur të konfirmojë vërtetësinë e videove. Shefi i policisë në Teheran, Hossein Rahimi, mohoi se ka pasur të shtëna në drejtim të protestuesve. "Policia nuk ka qëlluar drejt protestuesve, sepse oficerëve të kryeqytetit u është dhënë urdhër që të tregojnë përmbajtje", tha Rahimi. Hadi Ghaemi, drejtor ekzekutiv i Qendrës për të Drejtat e Njeriut në Iran - organizatë me seli në Nju Jork - tha se iranianët "duhet të lejohen të shprehin hidhërim dhe të kërkojnë përgjegjësi". "Iranianët nuk duhet të rrezikojnë jetën duke ushtruar të drejtën e tyre kushtetuese për tubime paqësore", tha Ghaemi. Në fluturimin e Ukrainës PS752 humbën jetën 82 iranianë, 57 kanadezë, 11 ukrainas, 10 suedeze, 10 afganë, tre gjermanë dhe tre britanikë. Irani ka ftuar Kanadanë dhe Ukrainën të marrin pjesë në hetime dhe ka thënë se ata që janë fajtorë, do të mbahen përgjegjës. Kryeministri i Kanadasë, Justin Trudeau, tha se do të kërkojë "drejtësi" për të vrarët. "Më vjen shumë keq për humbjen tuaj. Kjo tragjedi nuk do të duhej të ndodhte kurrë. Dua t'ju siguroj se e keni mbështetjen time të plotë gjatë kësaj kohe jashtëzakonisht të vështirë", tha Trudeau në një vigjilje për kanadezët e vrarë në tragjedi.



ATTA KENARE (AFP)

## Carles Puigdemont shkon në Parlamentin Evropian

Strasburg, 13 janar - Lideri katalanas, Carles Puigdemont ka zhvilluar seancën e tij të parë si anëtar i Parlamentit Evropian, pavarësisht fletarrestimit të lëshuar kundër tij në Spanjë. Ish-presidenti katalanas dhe ligjvënësi evropian do të shfrytëzojë Parlamentin për të vazhduar luftën e tij politike për një Katalonjë të pavarur dhe të ndarë nga Spanja. Përveç tjerash, pozicioni i tij parlamentar i garanton imunitet.

Puigdemont ka kërkuar lirimin e menjëhershëm nga burgu të liderit tjetër katalanas, Oriol Junqueras, i cili po ashtu është zgjedhur anëtar i Parlamentit Evropian, dhe ka qenë ish nën president në Katalonjë. "Ai duhet të jetë me ne këtu. Ai ka të drejtat e njëjta", ka thënë Puigdemont. Aftësia e tij për të diskutuar çështje të tilla në zemër të Bashkimit Evropian, përbën shqetësim për Spanjën e cila



kundërshton pavarësimin e rajonit të Katalonjës. Puigdemont ka arritur në Parlament me ish-ministrin katalanas, Toni Comín. Të dy kërkohen në Spanjë për rolin e tyre në tentimet e Qeverisë katalanase për pavarësi më 2017. Ata kanë ikur më pas në Belgjikë dhe në muajin maj janë zgjedhur anëtarë të Parlamentit Evropian si përfaqësues të partive separatiste nga Spanja.

# SIGMA

## VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË

### NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

*Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,*  
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:

• Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.

Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.

**Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju mirëpresim në zyrat e reja!**

### NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

*Dear clients and interested parties,*  
We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:

• Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.

We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

**Thank you for your understanding and welcome to the new offices!**

### OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

*Dragi klijenti i zainteresovane strane,*  
Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajućeg društva Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:

• Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.

Me ćemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajućeg društva na gore navedenu novu adresu glavne kancelarije.

**Hvala vam na razumevanju i dobrodošli u nove kancelarije!**



**SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË**

Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës


Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net) [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net)



# Michèle Gazier: Gjenitë me fytyrë ëngjëlli

I parakohshëm dhe i ditur si Jezusi duke folur për teologji me doktorët, djallëzor dhe i ëmbël si Kupidoni, Arthur Rimbaud me fytyrë engjëlli, me profilin e fëmijës, me fatin njëkohësisht shkëlqimtar e të zi, mishëron mrekullisht mitin e engjëllit të rrëzuar. Parakohshmëria e Rimbaud-së është shtylla e parë mbi ku ndërtohet miti në të cilin ai është në të njëjtën kohë heroi dhe viktimë. Parakohshmëri po aq shkrepitmatore sa poeti vetëvritet në moshën nëntëmbëdhjetëvjeçare dhe vdes pak ditë mbas ditëlindjes së tridhjeteshtatë. Para kësaj vdekjeje, ai zgjedh qetësinë e bredhjen, dy mënyra për t'u zhdukur që nuk kanë reshtur kurrë së ushqyeri polemikën e ndezur, imagjinatat.

Ka mes gjenisë dhe vdekjes lidhje të çuditshme e të frikshme. Gjenitë e vjetër nuk janë të numërt, madje nuk kanë, në sy të morive të turmave, popullaritetin e këtyre që kanë pasur fatin e madh ta marrin shumë herët nderimin e tyre.



Jean Genet

Simbolikisht, Rimbaud ka vdekur më pak se njëzet vjeç. Ç'do të ishte bërë me të nëse, si Hygoi, do t'i kishte shtuar gjashtë dekada proze e vargshesh veprës së vet?

Ta pret mendja, nuk mund të gjykojmë për jetëgjatësinë e njerëzve të shekullit XIX nën përmasën e të vetmit Hygo. Asokohe vdisje i ri dhe dyzetvjeçar nuk ishte larg një plaku. Megjithatë, në shekullin e Rimbaud-së, disa dekada para tij, janë të tjerë shkrimtarë të mëdhenj e dijetarë të shuar në kulmin e artit të tyre e në ag të moshës së të rriturit: poeti gjerman Georg Büchner, autor i *Woyzek*, ishte njëzet e katër vjeç kur u largua prej kësaj bote; Mikhaël Lermontov, të cilit i detyrohemi romanin shumë të bukur *Një hero i kohës tonë*, ishte njëzet e pesë vjeç. Për sa i përket matematikanit Évariste Galois, në moshën njëzetënjëvjeçare që zhduket, i goditur për vdekje në një duel; Isodore Ducasse, i ashtuquajtur Comte de Lautréamont, bashkëkohësi i

reptë i Rembaud-së e autor i të famshmeve *Këngë të Maldadorit*, e ka lënë këtë botë më 1870, në moshën njëzetekatërveçare, duke lënë mbas vetes një vepër të mister-shme, të çmendur, profetike, që shkrimtarë, psikanalistë e kritikë nuk reshtin së zbuluari. Një zë thyhet, por kënga e tij më shumë se kurrë mbetet.

Në rininë mitike të Rimbaud-së, që mbetet për lexuesit e vet përjetshëm adoleshent e bashkëfajtor, shtohet aureola e horrit, i të dorës së dytë, djaloshi endacak me flokë të pakrehur, "grushtet në xhepa të shpuar", vagabond e bohem. E përfytyrojmë "burrin me taban ere" duke i rënë kryq e tërthor Europës së mugullt, pijetoreve me nam të keq, alkoolin trimonedhash që të djeg fytyrën, djemtë që u qepen femrave, drogën, vetminë, kërkimin e dashurisë, miqësisë, hedhjen tek tjetri - fatkeqi Verlaine të mahnitur - që ju do shumë, shumë keq, që të ngjitet, që vdes prej dëshpërimit, prej xhelozisë...

"Nuk kam qenë kurrë prej këtij populli; nuk kam qenë kurrë i krishterë; jam prej racës që këndon në sfiljtë; nuk i kuptoj ligjet; nuk zotëroj kuptim të moralshëm, jam një i pagdhundur", - shkruante ai te *Një stinë në ferr*. Ai që "ende krejt fëmijë, do të adhuronte të burgosurin e paarsyeshëm i cili kyçet gjithmonë në burg", ruan mbyllët kepin e rrugëtarit drejt qyteteve të ndriçuara që do ta bënin ta harrojë jetën e ngushtë që nuk resht së arratisuri.

Dukshmëria që ne do ta quajmë romantike e këtyre viteve të dhimbshme endjesh e shkrimi, që do të zgjasin për kohë të gjatë mbasi ai pati mohuar dehjen prej fjalëve, me udhëtime të largëta e gje të tregtish të dyshimta e të dështuara në Perëndim, ka molepsur shkrimtarë e artistë. Në radhën e tyre ata kanë ëndërruar ose e kanë ëndërruar për veten e tyre, për gjeninë Rimbaud. Pse jo ata që kishin moshën e tij, sjelljet e tij, shijet e tij artistike a seksuale, shqetësimin e tij e ndonjëherë madje diçka prej sharmit të tij fizik.

### Diabolikët

Me më shumë apo më pak talent, më shumë apo më pak natyrshmëri, Rimbaud-të e rinj kanë lulëzuar në letërsi. Për ta filluar me Raymond Radiguet-in. Njëzetveçar, fizik i gjatë, shije e vërtetë e magjepsjes, mbrojtës i fuqishëm e besnik - Jean Cocteau - dhe një pendë e hollë. "Digjesha flakë, thekja hapin, si njerëzit që duhet të vdesin të rinj e që i grahen punës", - shkruante ai te *Djali në trup* në një lloj vetëportreti të lumtur e të dëshpëruar.

Prej kësaj vdekjeje të rrufeshme, Cocteau do ta kishte shumë të vështirë ta marrë veten dhe do ta kalojë pjesën e mbetur të

jetës duke kërkuar për Radiguet-Rimbaud-të me taban zjarri. Por nuk do të gabohet me gjeninë e re të parakohshme të zbuluar më 1955 nga botuesi i tij, René Julliard, një vajzë e vogël me shikim lehtësisht dyshues, me çehre të padjallëzuar, që shkruante vargje. Përballë kësaj çapëneje të pafajshme, Cocteau thotë me zë të lartë: "Të gjithë fëmijët nëntëveçarë janë gjeni, përveç Minou Drouet-it." Siç shkruan Roland Barthes në kapitullin e *Mitologjive* kushtuar poeteshës së re: "Sot, gjeni do të thotë të fitosh kohë, është të bësh në moshën tetëveçarë çka ne e bëjmë normalisht në moshën 25 vjeç. [...] Flitet për të ecur pak më shpejt se të gjithë njerëzit. Fëmijëria do të bëhet, pra, vendi i privilegjuar i gjenisë." Për fat, ky tip gjeniu nuk ka lënë shumë gjurmë. Shkëndija e saj nuk ishte e tillë sa të ketë ndriçuar një rrym.

### Martir

Në një gjini tjetër, e gjithmonë tek i njëjti botues René Julliard, një vajzë e re nëntëmbëdhjetëveçarë, Françoise Sagan, bën skandal në shkurrajën e letrave me një roman të parë, *Mirëdita trishtim*, që do të jetë njëri prej bestsellerëve më të mëdhenjve të shekullit. Ajo është provinciale, e lindur në Lot. Shkruan si t'i vijë, me paturpësi, duke ndër-marrë rreziqe, duke mos pasur frikë t'i djegë krahët as për t'i luftuar tabutë e një borgjezie që ajo e pikturon me vitriol.

Shkurt, Sagan jep ca shkelma në thneglën e romanit social e psikologjik. Muzika e saj e vogël ngazëllon, nuk pëlqen, intereson. Sido qofshim, të tronditur a të fituar, lexojmë Sagan. Vajza e re që ndien netët e bardha e lidhjet e rrezikshme, është e prekur nga mbrojtja e engjëllit dhe e fshikur nga krahu i djallit. Hija e Rimbaud-së rri pezull. Por ajo e ka jetën të ngjitur mbas trupit. Dhe, sado e brishtë, i tejkalon dekadat... Në mënyrën e vet, Sagan gjithashtu bëhet një mit. Qysh prej një gjysmë shekulli, botimi është në kërkim të një Sagani të re.

Në gjurmën e Rimbaud-së, shumë i afërt me të për nga vështirësia se nga parakohshmëria letrare, Jean Genet. Fëmijë i përbuzur, i braktisur nga nëna, nuk e njohu kurrë të atin. I ngulur në asistencën publike, edukohet prej ca fshatarëve nga Morvani. Një ditë akuzohet për vjedhje. Shkruan në *Ditar Hajni*: "Për t'i mbijetuar dëshpërimit, kur sjellja ime ishte më shumë e ndrydhur, përpunoja pa shpërblim një disiplinë të rrezikshme. [...] Për çdo akuzë të sjellë kundër meje, qoftë ajo e padrejtë, prej thellësisë së zemrës do të përgjigjesha po. Me zor e shqiptoja këtë fjalë. [...] thellë ndieja nevojën për t'u bërë ajo çka ata më kishin akuzuar se isha. Isha gjashtëmbëdhjetë vjeç." Dihet vazhdimi, shtëpi

riedukimi, arrati, vjedhje, prostitui, vagabondim, vjedhje, burg... mandej shkrimi vjen si një shëlbim për ta shpëtuar horrin. Në parathënien e pesëqind e shtatëdhjetë e katër faqeve që i kushton Genet-it nën titullin *Shenjtori Genet, komedian e martir*, Sartri shkruan sa i përket këtij akuzimi të parë për vjedhje, të cilit Genet-i do t'ia ruajë përgjithmonë gjurmën: "Një fëmijë vdes nga turpi, mbin në vend të tij një rrugaç; rrugaçi do të xhindoset nga fëmija." Bashkëbisedim i frytshëm mes të dyve që bën të lulëzojë kështu një vepër shëlbuese. Në të kundërt të Rimbaud-së, Genet-i do të shpëtohet me anën e të shkruarit.

### Në rrugë

Vepra e Rimbaud-së është si një lëkurë e çmuar që është krijuar në vuajtje dhe që ai e ka braktisur mbas vetes. Për poetin e Charleville-s si për këtë gjeniu tjetër fatkeq siç qe Moxart-i, zulma e pasvdekjes, krijimi i një miti, por pa shpëtim. Është pa dyshim ky fat i zi i Rimbaud-së, bredhja fatkeqe, lypja e pafundme e një vendi ku të ngjizet larg brengave të fëminisë, pakuptimësisë mëmësore, heshtjes së të atit, budallallëkut e mendjengushtësisë njerëzore që kanë frymëzuar shkrimtarët e brezit të Beat-it që përfaqësohen prej tij. Jehona e *Një stinë*

në ferr tringëllon në revoltën e tyre: Jam i armatosur kundër drejtësisë.

*Ia kam mbathur. O magjistarë, o mjerime, o urrejtje, ju që thesari im u qe besuar!*

*Ia dal të humbë ndjenjat në shpirtin tim e gjithë shpresa njerëzore.*

*Mbi çdo gëzim për ta mbytur linda kërcimin e shurdhët të kafshës së egër.*

### I ndyrë

Bert Mathieu, mik i ngushtë i Henry Miller-it e Allen Ginsberg-ut, profesor i vjetër në Universitetin e Yale-s, autor i një vepre mbi Rimbaud e Miller dhe përkthyes i veprës së Rimbaud-së, pohon që është Jack Kerouac që ia ka bërë të njohur Rimbaud-në Ginsbergut më 1944. Shkrimtarë të rrugës, revoltës, kundër një shoqërie të kalbur e shterpë, Kerouac, Ginsberg dhe në hapat e tyre këngëtarë, si Bob Dylan, Rolling Stones, Lou Reed e në veçanti Jim Morrison, zëri i Doors-ave, e kanë vënë Rimbaud-në në tekstet e jetën e tyre. Sipas Bert Mathieu, Mick Jagger e dinte Rimbaud-në përmendësh dhe Jim Morrison do të kishte bërë pelegrinazh në Charleville. Por përtej anekdotës, këtij ripërvetësimi të përhershëm të

ikonës e të dhunës së poetit të Ardenëve, nuk mundesh të jesh përveçse i kamufluar prej modernitetit të një vepre që, ngaqë është pa vend e pa epokë, sfidon kohën.

Por ç'do të kishte ndodhur me Rimbaud-në nëse fytyra e tij prej engjëlli nuk do të kishte shoqëruar vrullin e adoleshentit, gjeninë e tij të halabakut e bredhjen e tij të fëmijës së humbur? Engjëlli dhe horri. Skëterra e ferrit dhe ndriçimet e fjalëve. "Jam e ndyrë si Rimbaud", - këndon Brigitte Fontaine në një këngë të mrekullueshme e pa mesazh. "Jam i bukur si Rimbaud", - sugjeronte Jim Morrison mes shkëlqimeve të skenës e purgatorëve të parajsave të tij artificiale. Njëqind vjet më vonë, Rimbaud na rizgjon sërish. Në fillim të udhëtimit, na thotë ai, është përsëri deti, tresoja e fjalëve e vrujimi i dëshirës:

*Por, vërtet, shumë kam qarë! Agimet janë pikëllonjëse.*

*Çdo hënë është mizore e çdo qiell hidhët:*


*Dashuri helmët më ka mbufatë limontitë dehëse.*

*Ah sikur kallumca ime të vezul-lojë! Ah sikur të përfundoj në det!*

Marrë nga *Telarama hors serie*, kushtuar Arthur Rimbaud në 150-vjetorin e lindjes./*Exlibris Përktheu: Anila Xhekaliu*



Arthur Rimbaud



# “Tragjedia e liggjërimit” nga Eugène Ionesco

Gjer më 1948-ën Ionesco kishte shkruar disa ese, pak poezi dhe ndonjë artikull, ku spikatnin tashmë dukshëm përjetesat e absurdit. Mirëpo, kur vendos t'i hyjë mësimin të anglishtes, me metodën Assimil, i shkrep mendimi i një pjese, ku brofin fjali mekanike të një doracaku bisedimor. Këtu zë fill universi i pjesëve të tij aq të arrira, duke nisur me “Këngëtarja tullace”, ku këmbimi në erë e rrakapjekthi i fjalëve që s'ta mbushin syrin shndërrohen në pikënisje të një padie të hatashme ndaj pakuptueshmërisë dhe cektësisë së marrëdhënieve njerëzore.

Më 1948-ën, para se të shkruaja pjesën time të parë “Këngëtarja tullace”, nuk ma kishte fort ënda të bëhesha dramaturg. Thjesht, kisha vetëm ambicjen të mësoja anglisht. Mësuarja e anglishtes nuk të çon medoemos te dramaturgjia. Përkundrazi, ngaqë nuk ia dola dot mbanë të mësoja anglishten, pa u bëra shkrimtar pjesësh teatrore. Nuk është se këto pjesë i shkrova si për t'u hak-

marrë ndaj dështimit tim, megjithëse është thënë që “Këngëtarja tullace” përbënte një satirë të kulluar ndaj borgjezisë angleze. Po të më kishte shkrepur në kokë dhe të mos ia kisha dalë dot mbanë të mësoja italishten, rusishten a turqishten, do të thuhej po kaq ashikare se pjesa ishte rrjedhojë e kësaj përçapjeje të kotë, përbënte një satirë të hatashme për shoqërinë italiane,

ruse a turke. E ndjej se duhet të jap shpjegime më imtësore. Ja se çfarë ngjau: pra, për t'i hyrë anglishtes, bleva këtu e nëntë a dhjetë vjetë të shkuara, një doracak bashkëbisedimesh franko – angleze, për përdorim nga fillestarët. Iu futa punës. Me vetëdije të plotë, për t'i mësuar përmendsh, kopjoja fjali të tëra, të shkëputura nga librushka. Duke i rilexuar me shumë vëmendje, do

ti që nisa të mësoja, jo anglishten, por disa të vërteta befasonjëse: kështu, bie fjala, java paskësh shtatë ditë, gjë që gjithsesi e dija, ose ta zëmë që dyshemeja ndodhet poshtë, kurse tavani lart, gjë që e dija po ashtu, ndoshta, por, për të cilën nuk e kisha vrarë kurrë mendjen aq seriozisht a që mund ta kisha harruar fare dhe që, befas, po më shfaqej sa habitshëm, aq edhe padiskutueshmërisht e njëmendtë. Pa dyshim, që unë e kam aq fëllim filozofik, sa ta pikas që nuk po rishkruaja në fletorë time vetëm disa fjali thjeshtake angleze, të përkthyer në frëngjisht, por disa vërtetësi themelore, konstatime të thella. Megjithatë, ende nuk hoqa dorë nga anglishtja. Për fat të mirë sepse, pas të vërtetave universale, autori i doracakut më zbulonte

edhe disa të vërteta të veçanta, dhe për t'ia dalë mbanë, ky autor, i frymëzuar, padyshim, nga metoda platonike, i shprehte ato me anë të dialogut. Qysh nga mësimi i tretë spikat prania e dy personazheve, të cilët sot e kësaj dite nuk e di, nëse qenë të vërtetë a të sajuar: Z. dhe Znj. Smith, një çift anglez. Si për të më mrekulluar të gjithin sa s'thuhet, Zonja Smith i bënte të ditur të shoqit, se ata kishin shumë fëmijë, se banonin në rrethinat e Londrës, se mbiemrin e kishin Smith, se Zoti Smith ishte zyrtar, se kishin një shërbyese, Mary-n, po ashtu angleze, se që prej njëzet vjetësh kishin miq që quheshin Martin, se shtëpia e tyre ishte një pallat ngaqë “shtëpia e një anglezi përbën pallatin e tij të vërtetë”. Po thosha pak më sipër që Zoti



Smith duhej të ishte disi në dijeni për gjithë këtë. Mirëpo, ku i dihet, ndonjëherë ka edhe njerëz tejet të hutuar. Nga ana tjetër, bëjmë mirë t'u kujtojmë të ngjashmëve tanë gjëra që mund t'i harrojnë a për të cilat nuk janë edhe aq të vetëdijshëm. Përtej këtyre vërtetësive të veçanta, gjithëkohore ishin edhe disa të vërteta të tjera çastore, që shfaqeshin qartas: bie fjala, që Smith-ët sapo kishin ngrënë darkë dhe që ishte ora nëntë e mbrëmjes, me orën angleze, sipas sahatit me lavjer-rës.

Më lejoni t'ju tërheq vëmendjen rreth karakterit të padyshueshëm, përsosmërisht aksiomatik të pohimeve të zonjës Smith, si dhe rreth përcapjes kryekëput karteziane të përpiluesit të doracaktum tim të anglishtes, sepse ajo që shquante në të ishte përparimi sipëror metodik i kërkimit të së vërtetës. Në mësimin e pestë ia behnin Martin-ët, miqtë e Smith-ve. Ndizej bashkëbisedimi mes të katërve dhe, përmbi aksiomat fillestare ngriheshin të vërteta më plotësore: "fshati është më i qetë se qyteti i stërmadh", pohonin disa, "po, por në qytet popullsia është më e dendur ama, ka më shumë shitore", ia prisnin të tjerët, çka është mëse e vërtetë dhe dëshmon, për më tepër, që vërtetësitë kundërshtore mund të bashkëjetojnë për bukur.

Sakaq, më shkrepni befasi një mendim. Për mua nuk bëhej më fjalë të përsosja njohjen e gjuhës angleze. Të jepesha pas pasurimit të fjalorit tim në anglisht, të mësoja fjalë për të përkthyer në një gjuhë tjetër, atë çka mund ta shprehja bukur fort në frëngjisht, pa marrë parasysh "përmbajtjen" e këtyre fjalëve, se ç'kumtonin ato, do të ishte njëllor si të bije në mëkatën e formalizmit, të cilin sot diturakët e mendimit e dënojnë me plotë të drejtë. Ambicja ime kishte marrë përmasa më të mëdha: t'u përcillja bashkëkohësve të mi të vërtetat thelbësore, që më kishte sjellë ndërmend doracaku i bashkëbisedimeve franko-angleze. Nga ana tjetër, dialogjet e Smith-ve, Martin-ve, e Smith-ve dhe Martin-ve, ishin mirëfilli teatër, meqë teatri është dialog. Më duhej, pra, të shkruaja pikërisht një pjesë teatrore. Dhe shkrova, kështu, "Këngëtarja tullace" e cila është një pjesë teatrore kryekëput didaktike. Po përse kjo vepër quhet "Këngëtarja tullace" e jo, bie fjala, "Anglishtja pa mundim", siç më shkrepni ta emërtoja së pari, as "Ora angleze", siç ma pat ënda ta quaja një çast më pas? Ha gjatë, po t'i vihesh ta shkoqitësh: njëra nga arsyet për të cilat "Këngëtarja tullace" u emërtua kështu, qëndron në faktin që aty nuk shfaqet asnjë këngëtare, tullace a ma flokë qoftë. Ky detaj duhej të mjaftonte. Një pjesë e mirë e veprës përbëhet nga vënia kokë më kokë e fjalëve të nxjerra prej libërthit të anglishtes. Smith-ët dhe Martin-ët e të njëjtit dora-

cak janë Smith-ët dhe Martin-ët e pjesës sime. Janë po ata, shqiptojnë të njëjtat thënie, bëjnë të njëjtat veprime a të njëjtat "joveprime". Në çdo "teatër didaktik" nuk të mbetet të jesh original, as të thuash atë që mendon vetë: kjo gjë do të përbente një gabim të rëndë kundër "të vërtetës" objektive. Nuk na mbetet veç të përcjellim, urtësisht, vetë mësimin që na ishte përcuar, idetë që na ishin ngulitur. E si mund t'i lejoja vetes t'u ndryshoja gjënë më vocërrake atyre fjalëve që shprehnin në mënyrë kaq të përkorë të vërtetën absolute? Duke qenë "autentikisht" didaktike, pjesa ime, nuk duhej të ishte kurrsesi, sidomos originale, pa le shpërfaqëse e talentit tim!

...Megjithatë, teksti i "Këngëtares tullace", qe mësim (dhe kopjim) vetëm në fillim. Nuk di ta them se si ngjau një dukuri mjaftë e çuditshme: krejt pa u ndjerë, teksti u shndërrua në sytë e mi, përtej çdo dëshire nga ana ime. Fjalitë tejet të thjeshta e regëtuese, që pata mbajtur shënim me aq ëndje në fletorkën time, të braktisura aty, pas njëfarë kohe, sikur u tjetërsuan, lëvizën vetiu, u shkapërdrohën, u shpërfytyruan. Fjalitë bisedimore të doracaktum të cilat, gjithsesi, i pata kopjuar me mjaftë saktësi e në mënyrë aq sqimatare, u çakërdisën njëra pas tjetres. Po kështu, e pësoi edhe kjo e vërtetë e pamohueshme, mëse e sigurt: "dyschemeja ndodhet poshtë, tavani është lart". Pohimi – po aq i prerë, sa edhe i qëndrueshëm: shtatë ditët e javës janë, e hënë, e martë, e mërkurë, e enjte, e premte, e shtunë, e dielë – u zhbë dhe Z. Smith, heroi im, këmbëngulte se java u përbëkësh nga tri ditë, të cilat qënqeshin: e marta, e enjtja dhe e marta. Personazhet, borgjezët e mi çapkënë, Martin-ët, burra e grua, i goditi sëmundja e amnezisë: edhe pse shiheshin e flisnin çdo ditë me shoshonin, ata nuk e njohën dot më njëri-tjetrin. Ndodhën edhe gjëra të tjera llahtarisëse: Smith-ët na vunë në dijeni për vdekjen e njëfarë Bobby Watson, që nuk kish Zot ta identifikonte, sepse ata na vinin po ashtu në dijeni që tre të katërtat e banorëve të qytetit, burra, gra, fëmijë, maçokë e ideologë mbanin emrin Bobby Watson. Një personazh i pestë i papritur ia beh, më në fund, për të theksuar turbullirën e dergjive paqtoare, kapiteni i zjarrfikësve, i cili tregonte rrëfenja në të cilat, me ç'dukej, bëhej fjalë për një demriosh që mund të kishte pjellë një vemje të stërmadhe, për një mi të mbarsur që mund të pillte një mal. Mandej, zjarrfikësi ikte që të mos i shkonte huq një zjarr i cili duhej të binte në anën tjetër të qytetit, i paralajmëruar qysh prej tri ditësh, shënuar në bllokun e tij të xhepit. Ndërkohë, Smith-ët dhe Martin-ët po nisnin sërish bashkëbisedimin. Ta hajë drejt! Të vërtetat e mirëfillta dhe ditur-

rake që shkëmbenin, të kokolepsura njëra pas tjetres, qenë çmendur plotësisht. Ligjërimi kishte lajthitur. Personazhet ishin shpërbërë. Fjala, absurde, qe zbrazur e s'i kishte mbetur më përmbajtje. Gjithçka përfundonte në një grindje, që vështirë se mund t'ia merrje vesh shtysat, ngaqë heronjtë e mi nuk ia ngjishnin shoshonit në surrat me fjali a copëza fjalish, as me fjalë, por ose me rrokje, ose me bashkëtingëllore a zanore...!


...Për mendimin tim, duhej të kishte ngjarë ndonjë shkrehje e reales. Fjalët qenë shndërruar në lëvizje tingullore pa pikë kuptimi. Afërmendsh që edhe personazhet qenë zbrazur nga psikologjia dhe bota më shfaqej në një zbardhëllimë të pazakontë, ndoshta me dritën e saj të njëmendtë, përtej interpretimeve e ndonjë shkakësie arbitrare.

Duke shkruar këtë pjesë (sepse kjo qe shndërruar në një lloj pjesë a anti – pjesë, domethënë një parodi e vërtetë pjesë, një komedi komedie), më kishte mbërthyer një angushti e njëmendtë, marramendje, neveri. Hera-herës isha i detyruar të ndërprisja punën dhe duke i bërë pyetjen vetes se ç'dreqin më shtynte të vazhdoja të shkruaja, shkoja e shtrihesha në kanape me frikë se mos shembe-

sha tok me të në zbrazëtirë. Kur e përfundova, ama, këtë punë, e ndjeva veten shumë krenar. Përfytyroja që kisha shkruar diçka si "tragjedia e ligjëritit"! Kur u vu në skenë, unë thajse habitesha, tek dëgjoja të qeshurat e spektatorëve që e morën (dhe vazhdojnë ta marrin) këtë gjë gëzueshëm, duke e mbajtur gjithçka për komedi. Disa nuk u gabuan (në mes tyre Jean Pouillon-i), teksa e ndjenë angushtinë. Madje disa të tjerë pikasën se aty vihej në lojë teatri i Bernstein-it dhe aktorët e tij. Komedianët e Nicolas Baille-it e kishin vënë re këtë gjë qyshkur, teksa e luanin pjesën (sidomos në shfaqjet e para) pors melodramë. Më pas, duke e zbërthyer veprën, disa kritikë seriozë e diturakë e interpretuan vetëm si kritikë ndaj shoqërisë borgjeze dhe si parodi të teatrit të Boulevard-it. Sapo thashë që edhe unë e tumir këtë interpretim: megjithatë, në mendjen time nuk bëhet fjalë për satirizim të mendësisë mikroborgjeze në lidhje me këtë apo atë shoqëri. Në të, bëhet fjalë, sidomos, për njëfarë mikroborgjezi universale, meqë mikroborgjezi është njeri i mendimeve kallëp, i sloganeve, konformist i kudogjindshëm: këtë konformizëm, sigurisht, e

ngërthen "ligjërimi i tij automatik". Teksti i "Këngëtares tullace", a i doracakut për të mësuar anglisht (rusisht a portugalisht), i përbërë nga shprehje të ngurta, klishe nga më patakësset, po më zbulonte dora-dorës shtampat e ligjëritit, të sjelljes së njerëzve, "të folurën për të mos thënë kurrëgjë", të folurën ngaqë s'të ka mbetur gjë vetjake për të thënë, mungesën e jetës shpirtërore, mekanikën e përditshmërisë, njeriun që dremrit në mjedisin e vet shoqëror, pa e bërë fare qejfin qeder: Smith-ët, Martin-ët nuk dinë më të flasin, sepse ata nuk dinë më të mendojnë. Ata nuk dinë më të mendojnë, sepse nuk dinë më të emocionohen, nuk kanë më pasione, nuk dinë më të jenë, ata mundin "të shndërrohen" në tjetërkënd, në shumëçka, sepse duke mos qenë vetja, janë thjesht të tjerët, bota e jovetjakësisë, ata janë vetëm të ndërkyembyeshëm: mund të vendoset Martin-i në vend të Smith-it e anasjelltas, pa rënë në sy kurrëgjë. Personazhi tragjik nuk ndryshon lehtë, por thyhet. Ai është vetvetja, është real. Personazhet komike janë njerëz që nuk ekzistojnë...

/Exlibris/ Përktheu nga frëngjishtja Luan Canaj



E jashtëzakonshme

## Dentisti heq dhëmbin më të madh në botë

Një dentist gjerman u bë i njohur pasi nxori dhëmbin më të gjatë në histori. Mjeku Max Lukas zbuloi se pacienti kroat kishte një dhëmb jashtëzakonisht të madh që shkaktonte ënjtje të nofullës së sipërme. Ai e informoi pacientin se rasti është i rrallë dhe se ai duhej ta nxirrte dhëmbin sa më shpejt që të ishte e mundur. Dhëmbi i pacientit ishte 3.72 cm i gjatë dhe ishte dhëmbi më i gjatë i gjetur ndonjëherë te një



njeri. Pas operacionit, pacienti u lirua nga dhimbja dhe mjeku shkoi në Librin e Rekorderve Guinness për t'i regjistruar arritjet e tij.

FOTO E DITES



Një burrë në Kashmir shihet duke transportuar thasë me qymyr. /AP/

E rrallë

## A do të drekonit në një shtëpi akulli?

Nëse jeni kurioz tani keni mundësi. Në Harbin, kryeqendra e provincës Heilongjiang në Kinën Verilindore, është ndërtuar një shtëpi akulli. Qytetarë të shumtë kuriozë, por edhe të joshur nga ushqimi, kanë zgjedhur të hanë aty. Ata ulen në karrige akulli dhe hanë ushqim. Kjo përvojë e veçantë e ngrënies në këtë dimër të ftohtë ka tërhequr shumë qytetarë.



## BARSOLETA E DITËS



Një qel duke shëtitur në park e takon një njeri pa dhëmbë.  
Qeli e pyet atë si me humor: Me çka i lanë dhëmbët?  
Ai i përgjigjet: Me gel!



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno




#### Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min  
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.  
**Regjia:** Jake Kasdan



#### Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min  
**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj  
**Regjia:** J.J. Abrams




#### Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu




Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: Kino ABC.



**DASHI**  
Do të jeni dinamik dhe shkëlqyes, do ta veçoni aftësinë tuaj për të shijuar çdo çast.



**DEMI**  
Të zemëro-hesh është pothuajse e pashmangshme. Mund ta irritoni partnerin tuaj.



**BINJAKËT**  
Lajmet që po prisni po vijjnë, nuk ka nevojë t'i kërkonit ato. Jeta në çift kërkon më shumë vëmendje.



**GAFORRJA**  
Tërhiqni telat e çantës, në këtë moment ju piren të shpenzoni shumë lehtë. Saktësisht pastroni një keqkuptim të trashë me partnerin.



**LUANI**  
Ju jeni mbështetur nga miq, të inkuruar juar nga Hëna në shenjën tuaj. Për sa i përket detyrave, sot mund të paguani pak.



**IRGJËRESHA**  
Bëni ditët tuaja më kuptimplotë. Dëshironi më shumë çaste angazhuese me partnerin tuaj.



**PESHORJA**  
Ditë e gëzuar: Ditën e sotme do të ketë shumë gjallëri dhe shumë mundësi që nuk duhen humbur.



**AKREPI**  
Hëna dhe Venusi ngadalëson një rrugën tuaj sot. Në fakt, ju dukeni pak të lodhur dhe të pamotivuar.



**SHIGJETARI**  
Sharmi dhe komunikimi i bukur janë pikërisht ato që duhen për të nxjerrë në pah në fushën sociale.



**BRICJAPI**  
Përmirësoni mirëkuptimin e çiftit dhe do ta demonstroi atë, duke e mbushur partnerin tuaj me vëmendje të vogla dhe të mëdha.



**UJORI**  
Do të jetë një ditë e fshehtë për marrëdhëniet personale që mund të përjetojnë momente kritike. Qëndroni të qetë!



**PESHQIT**  
Do të jetë një ditë e qetë, por nuk mund të qëndroni gjithë kohës në dafina. Duhet ta organizoni jetën tuaj të përditshme dhe mënyrën tuaj të të ushqyerit ndryshe.

## Brad Pitti: Unë u shërova nga alkoolizmi



Aktori i Hollywoodit, Brad Pitt, ka folur hapur për problemet e veta të varësisë një vit e gjysmë më parë. Alkoolizmi shkatërroi martesën e tij me Angelina Jolien dhe e largoi nga fëmijët, dhe Pitt është sot i matur falë miqve të tij të ngushtë. Si shumë yje, Brad Pitt u bë një alkoolist. Për një kohë të gjatë, ai

mohoi problemin e tij dhe pasi u nda nga Jolie dhe luftoi për kujdestarinë e fëmijëve të tyre, 56-vjeçari u hodh në pah dhe vendosi ta rregullojë jetën e tij. Rruga drejt shërimit, përveç institucioneve profesionale, Pitt sot falënderon jashtëzakonisht shumë kolegë e aktrimit dhe mikun e gjatë, Bradley Cooper.



## Filmi 'Joker' udhëheq në nominimet për çmimet filmike Oscar

Akademia e Arteve dhe Shkencave në Shtetet e Bashkuara ka bërë me dije nominimet e filmave në 24 kategori për çmimet Oscar, për ta nderuar përkushtimin e bërë në fushën e filmit më 2019. Filmi "Joker" është nominuar në 11 kategori, duke përfshirë atë për

filmin më të mirë, aktorin më të mirë dhe për tetë çmime të tjera. Tre filmat e tjerë: "The Irishman", "1917" dhe "Once Upon a Time... in Hollywood" kanë secili nga 10 nominime. Ceremonia e 92-të e ndarjes së këtyre çmimeve do të mbahet më 9 shkurt në Los Anxhelos në Teatrin Dolby.

## Butrinti nuk ka vetëm vendin e parë, por shtatë vendet e para



Nuk ka ndodhur kurrë më parë në historinë e "Top Awards", por Butrint Imeri ka vendosur të sjellë një rekord të ri pasi artisti ka arritur ta zë jo vetëm vendin e parë, por shtatë vendet e para. Duket se paraqitja e artistit në programin "Shiko kush luan" ka dhënë frytet e veta, pasi menjëherë

pas kësaj pjesëmarrjeje fansat e kanë renditur menjëherë në kreun e 100 këngëve më të bukura të muzikës moderne shqiptare. Pauza e shkurtër e Butrintit në muzikë ka bërë që artisti të jetë më i fuqishëm se kurrë në treg dhe këtë e tregon më së miri ky klasifikim i ditës së sotme.

## Adele humbet 45 kilogramë



Këngëtarja britanike Adele ka humbur 45 kilogramë dhe ka shndërruar trupin falë një serie ndryshimesh në stilin e jetës. Adele raportohet se ka humbur në mënyrë të shpejtë 45 kilogramë të tepërt nga trupi i saj. Ajo u shfaq në fotografi e veshur me një fustan të

shkurtër lulesh në një festë me James Corden dhe Harry Styles. Në një moment Adele shihet duke folur me fansat dhe duke ua treguar atyre sekretin e dobësisimit. Adele shihet tani jo vetëm si një këngëtare me zë fantastik, por edhe si një dietologe e mirë.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

# Lojtarët e Superligës u paraqitën mirë për Kosovën

Lojtarët e Superligës së Kosovës janë paraqitur mirë për Përfaqësuesen e Kosovës në miqësoren ndaj Suedisë, kanë vlerësuar dy futbollistët me përvojë të madhe, Labinot Osmani dhe Taulant Dajaku. Ata kanë shprehur optimizëm se kjo ftesë do të shërbejë pozitivisht për lojtarët e rinj që të punojnë më shumë për të arritur të ftohen në Përfaqësuese. Nga trembëdhjetë lojtarët e ftuar të Superligës debutuan nëntë prej tyre



**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 13 JANAR** - Dy lojtarët me përvojë të madhe në futbollin e Kosovës, Labinot Osmani dhe Taulant Dajaku, e kanë vlerësuar pozitive paraqitjen e lojërave të IPKO Superligës për Përfaqësuesen e Kosovës në miqësoren e zhvilluar ndaj Suedisë në Katar (1-0). Sulmuesi aktual i Llapit, Labinot Osmani, ka thënë për "Epokën e re" se në përgjithësi paraqitja e lojtarëve nga kampionati vendor ishte e mirë. "Mendoj se Përfaqësuesja e Kosovës nga ndeshja në ndeshje ka shënuar ngritje të nivelit të lojës. Po ashtu, edhe paraqitja e lojtarëve të Superligës ka qenë pozitive, duke mos dashur që të dalloj dikë më shumë apo më pak", ka thënë Osmani. Sulmuesit i ka mbetur merak që ai dhe shumë të lojtarë të tjerë nuk e kanë pasur fatin të luajnë me Kosovën në ndeshje ndërkombëtare, pasi futbollit i Kosovës nuk ishte i pranuar në

UEFA dhe FIFA. "Po sikur Kosova të ishte pranuar në FIFA dhe UEFA sigurisht se kisha shpresuar në ftesën e selektorit, por që mendoj se pranimi i Kosovës në instancat më të larta të futbollit ka bërë që shumë lojtarë të mos kenë paraqitje për Kosovën", ka shtuar Osmani. Fjalë të mira për paraqitjen e lojtarëve të kampionatit vendor në ndeshjen miqësore që Kosova e zhvilloi ndaj një kundërshtari të fortë siç është Suedia, pati edhe Taulant Dajaku. "Është një sinjal i mirë për të rinjtë në vend se ruga për t'i kapur majat e futbollit është nga puna që bëjnë dhe nëse punojnë mirë dhe me përpjekje një ditë do t'u shpagueh munda. Federata ka bërë mirë që ka organizuar këtë ndeshje dhe iu ka dhënë rasti disa lojtarëve të mirë nga liga jonë për të shfaqur në përballje me një ekip kombëtar si ai i Suedisë", ka thënë Dajaku për gazetë. "Uroj që djemtë që kishin rastin të grumbullohen ta shfrytëzojnë këtë gjë për t'i hapur rrugët e veta drejt

ekipeve në liga edhe më të larta dhe njëkohësisht kjo ftesë për lojtarët e Superligës do t'u shërbejë edhe lojtarëve që nuk janë ftuar që të motivohen për të fituar ftesë në të ardhmen", ka deklaruar Dajaku. Mesfushori aktual i Ferizajt e ka kujtuar edhe grumbullimin që e kishte në kohën kur përzgjedhës ishte Edmond Rugova dhe Kosova nuk ishte e pranuar në arenën ndërkombëtare. "Mbah në mend se në vitin 2010 kishim një grumbullim me përfaqësuesen kur selektor ishte Edmond Rugova dhe unë isha i ftuar në atë grumbullim 10 ditore edhe pse në atë kohë nuk ishim të pranuar në UEFA, impakti dhe motivi që më krijoi ajo ndjesia e të ftuarit në përfaqësuese të motivonte pafund për t'u përkushtuar dhe për të punuar edhe më shumë", ka përfunduar Dajaku. Ndryshe në ndeshjen e zhvilluar të dielën në Doha të Katarit Kosova pësoi humbje nga Suedia (1-0), por pati paraqitje shumë të mirë.

**SHKURT**

**Hodaj dhe Shala përforcojnë Dukagjinin**

Skuadra e Dukagjinit të Klinës është përforcuar të hënën me dy futbollistë. Portieri Drin Hodaj dhe mbrojtësi Arbër Shala janë përforcimet me të reja të skuadrës që renditen në pozitën e fundit në Superligë. "Portieri Drin Hodaj vjen nga klubi i Drenicës dhe vesh fanellën e klubit tonë gjatë fazës së dytë në IPKO Superligën e Kosovës. Mbrojtësi i krahut të majtë, Arbër Shala, përforcon vijën e fundit në ekipin tonë dhe vjen nga klubi prizrenas, KF Liria. Ne ju urojmë mirëseardhje dhe shumë sukses", thuhet në njoftimin e KF Dukagjini.

**Kokaj u diskualifikua në disiplinën e sllallomit të madh**

Skitari i Kosovës, Drin Kokaj, garoi të hënën në disiplinën e sllallomit të madh në Lojërat Olimpikë Dimërore për të Rinj "Lozana 2020". Kokaj gjatë lëshimit të parë bëri një gabim, për çka u diskualifikua. Drini do të garojë edhe sot (e martë) në sllallom. Në Lozana 2020, Kosovën e përfaqësoi edhe skitarja Era Shala, e cila të shtunën theu këmbën, me ç'rast iu pamundësua pjesëmarrja në gara.

**Fenerbahçe refuzon edhe Fiorentinën për Muriqin**

Fenerbahçe ka refuzuar edhe ofertën e dytë brenda një kohe të shkurtër për sulmuesin e Përfaqësueses së Kosovës, Vedat Muriqi. Pas Tottenhamit, skuadra turke e ka refuzuar edhe Fiorentinën. Lajmi është bërë me dije nga e përditshmja turke "Sabah". 25-vjeçari ka shënuar 11 gola në 17 ndeshje për Fenerbahçen. Gjatë karrierës, Muriqi në Turqi ka luajtur edhe te skuadrat si Gençlerbirliği e Giresunspor.

**Mustafi, afër Galatasarayt**

Mbrojtësi Shkodran Mustafi pritet të largohet nga Arsenalin në këtë afat kalimtar, pasi nuk është pjesë e planeve të trajnerit, Mikel Arteta. Mediat angleze dhe turke raportojnë se Mustafi është shumë afër kalimit në Galatasaray, derisa kanë mbetur vetëm disa detaje të vogla që të mbyllet transferimi. 27-vjeçari që ishte transferuar te skuadra londineze për 40 milionë euro nga Valencia, kishte treguar formë të lartë në sezonet e para. Por, forma e tij ka pësuar rënie dhe tani dëshiron ta vazhdojë karrierën në Turqi.

**Rick Jeksonin përforcon Pejën**

KB Peja ka njoftuar se ka transferuar zyrtarisht Rick Jeksonin. Basketbollisti që është i gjatë 206 centimetra, luan në qendër, derisa njihet për kërcimet e tij në trapez, si bllokues dhe si mbrojtës fantastik. "Rick njihet për kërcimet e tij në trapez, bllokues dhe mbrojtës fantastik. Ai është shumë aktiv në lojë dhe ka aftësi të shkëlqyera në lëvizjet e sulmit. Në vitin 2013 arriti në gjysmëfinale të NBA D League. Rick në vitin 2016 arriti të ishte gjysmëfinalist në France Pro-B. Po ashtu, ishte zgjedhur i 9-ti në NBA D-League", ka njoftuar KB Peja. "Në vitin 2014 ishte finalist i Ballkan League, ku ka luajtur në ekipin e Izraelit, Gilboa. Ai ka luajtur edhe kundër klubit tonë dhe ka arritur të ishte finalist. Ai ishte pjesë e Iowa Energy, Delaware 87ers në D-League. Pastaj karrierën e ka vazhduar edhe në Republikë Domenikane, Argjentinë, Uruguai dhe Kili", thuhet në njoftimin e KB Peja.

**Sonte zhvillohet derbi shqiptar në Ligën Ballkanike**

Prishtinë, 13 janar - Sot (e martë) do të zhvillohet derbi shqiptar në Ligën Ballkanike ndërmjet Vllanizës së Shkodrës dhe Pejës. Vllaznia ka një fitore dhe katër humbje deri më tani, kurse ekipi pejan ka tri fitore

dhe tri humbje. "Verdhezinjtë" kanë bërë disa përforcime për stinorin pranveror, ku transferimi më i madh pa dyshim mbetet Dardan Berisha, por edhe me disa lojtarë të tjerë në mënyrë që t'i arrijnë synimet që

kanë. Në sfidën e parë ndërmjet këtyre dy skuadrave kishte triumfuar Peja në "Karagaçi" me rezultat 78:67. Ndeshja në Shkodër do të zhvillohet më 14 janar nga ora 18:00.



## Sot mblidhen të gjithë kapitenët e klubeve të futbollit për rastin e Arben Beqirit

PRISHTINË, 13 JANAR - Bordi i Shoqatës për Mbrojtjen e të Drejtave të Futbollistëve të Kosovës sot (e martë) në orën 11:45, në ambientin e FFK-së, ka ftuar të gjithë

kapitenët e klubeve të futbollit të Kosovës të marrin pjesë në një takim informues në lidhje me hapat konkretë që t'i dalin në ndihmë Arben Beqirit,

portier në klubin futbollistik Trepça '89, i cili është i diagnostifikuar me tumor në lukth. "Në këtë takim ftohen edhe mediat e portalet, dashamirët e futbollit

dhe shoqëritë e tjera që kanë vullnet të mirë për ta përkrahur Arbenin përgjatë kësaj sfide shëndetësore", thuhet në njoftimin e ShMDFK-së.



# Kupa 'Nënë Tereza' fillon në mars, pjesëmarrëse tri kategoritë

TIRANË, 13 JANAR - Bashkimi i shqiptarëve po vjen dhe, ashtu siç të gjithë janë të ndërgjegjshëm, kurrsesi nga politika. Do të jetë sporti që do t'i bëjë bashkë shqiptarët e Kosovës dhe ata të Shqipërisë. Kupa e re e quajtur "Nënë Tereza", e cila është mirëmbledhur nga organizatorët, e iniciuar nga presidenti i FShF-së, Armand Duka, është përcaktuar në projekt që të nisë në muajin mars-qershor të 2020. Sipas asaj që raporton "Top Channel", do të marrin pjesë tri kategoritë e futbollit. Kategoria Superiore e Shqipërisë që ka 10 ekipe dhe Kosovës që ka 12 ekipe. Kategoria e Parë e Shqipërisë që është me 20 ekipe dhe Kategoria e Parë e Kosovës që ka 16 ekipe. Kategoria e Dytë e Shqipërisë ku luajnë 26 ekipe, ndërsa e Kosovës që ka 16 ekipe. Të gjitha këto skuadra do të marrin pjesë në Kupën "Nënë Tereza", por 22 ekipet e elitës së



futbollit në Kosovë dhe Shqipëri do të shkojnë direkt në fazën 1/32. Ndërsa 80 ekipet e Kategorisë së Parë dhe të Dytë do të luajnë me njëri-tjetrin në sis-

temin vajtje-ardhje në stadiumet e tyre. Faza e parë do të ketë 140 ndeshje, ndërsa për të mbërritur në finalen e madhe do të duhen 201 ndeshje.

# San Antonio përmbysi Toronton

TORONTO, 13 JANAR - Skuadra e San Antonios fitoi me rezultat të ngushtë 105-104 ndaj Torontos, një ndeshje e vendosur në minutën e fundit në favor të Spursit. Kampionët kanadezë e dominuan takimin në shumicën e kohës (Ibaka 21 pikë e 14 rebound), duke u shkëputur deri në 18 pikë. Gjithsesi, në fund erdhi përmbysja e San Antonios, ku u dallua DeRozan me 25 pikë. Fitore ka shënuar edhe ekipi i Memphisit, që mundi me rezultat 122-102 Golden State, ndeshje e vendosur në pjesën e dytë. Ndeshje e mirë e Valanciunas, me 31 pikë e 19 rebounde, raporton "Telesport". Skuadra e Denverit



arriti një fitore të rëndësishme ndaj Clippersave me shifrat 114-104, përballje mes dy ekipesh rivale në Konferencën e Perëndimit. 7 lojtarë të Denverit realizuan mbi 10 pikë (Nikola Jokiq 20 pikë e 15 rebounde), ndërsa 30 pikët e Leonardos për

miqtë mbetën për statistikë. New Yorku, falë 26 pikëve të Randles dhe 23 të Barrett, e mposhti me rezultat 124-121 Miamin, ndërsa Phoenixi triumfoi me rezultat 100-92 ndaj Charlottes (Oubre 25 pikë e 15 rebounde).

### REZULTATET

New York - Miami	124-121
Washington - Utah Jazz	116-127
Brooklyn - Atlanta	108-86
Memphis - Golden State	122-102
Toronto - San Antonio	104-105
Denver - Clippers	114-104
Phoenix - Charlotte	100-92

### SHKURT

#### Përfundon sezoni për Demiralin dhe Zaniolon

Sezoni ka përfunduar për mbrojtësin e Juventusit, Merih Demiral, i cili ka këputur ligamentin në ndeshjen kundër Romës (1-2). Pas testeve të kryera të hënën është konfirmuar se lojtari turk do të operohet dhe ky lëndim pritet ta mbajë jashtë fushës për të paktën gjashtë muaj, duke ia pamundësuar paraqitjet në pjesën e mbetur të sezonit, por duke zvogëluar edhe shanset që ai të paraqitet në "Euro 2020" me Turqinë. Fatin e njëjtë me Demiralin e ka edhe mesfushori i Romës, Nicolo Zaniolo, i cili pritet të mungojë mes gjashtë deri në nëntë muaj pas këputjes së ligamentit të gjurit. Zaniolo u lëndua gjatë humbjes 2-1 nga Juventusit të dielën. Mediat italiane raportojnë se testet mjekësore kanë konfirmuar dëmtimin serioz dhe se sezoni ka përfunduar për 20-vjeçarin.

#### Kjaeri prezantohet te Milani

Drejtuesit e Milanit prezantuan të hënën futbollistin danez Simon Kjaer. Ky i fundit është në pronësi të Sevillas, por fazën e parë e kaloi në huazim te Atalanta, ndërsa tani do të jetë në huazim te Milani deri në fund të sezonit, me kuqezinjët që kanë ruajtur edhe të drejtën e blerjes përfundimtare të kartonit. Mbrojtësi danez 30-vjeçar ka një përvojë të madhe pasi ka luajtur me skuadra si Palermo e Roma në Itali, por edhe Lille, Fenerbahçe, Wolfsburg etj. Në Evropë, ndërsa tani do të vihet në dispozicion të Piolit dhe mund të debutojë të mërkurën në mbrëmje në ndeshjen e kupës përballë Spalit.

#### Stones në verë largohet nga City



E ardhmja e John Stones te Manchester City nuk është e sigurt. Mbrojtësi anglez ka pasur luhajtje në paraqitjet e tij, ndërsa dëmtimet e shumta nuk e kanë ndihmuar atë të japë më të mirën çka i ka shtyrë drejtuesit të mos i rinovojnë kontratën që skadon në 2022-shin. Trajneri Pep Guardiola ka preferuar edhe mesfushorët Fernandinho e Rodri në mbrojtje në vend të Stones, i cili në verë për një ofertë serioze mund të largohet nga City.

#### Trajneri i Rubin Kazanit: E dua në ekip Mbappen

Ish-trajneri i Rosisë, Leonid Slutsky, ka zgjedhur Kylian Mbappe si lojtarin ideal për ekipin e tij, Rubin Kazan. Nuk dihet pse Slutsky ka bërë këtë deklaratë në një kohë kur ylli i PSG-së dhe kampioni i botës, Mbappe, po refuzon ekipe si Real Madridi. "Ndërmërisht do të thosha që Messi dhe Ronaldo janë opsione në sipërfaqe, por unë do ta merrja Mbappen. E para, është më i shtrenjtë, si dhe më i riu, më i shpejtë dhe më premtuesi", ka thënë Slutsky. Jo pak lojtarë të talentuar zgjidhen disa vite më parë të luanin në Rusi si Hulk apo Willian, por më pas u larguan.

#### Zbulohen detaje të reja nga vdekja e Emiliano Salas

Detaje të reja kanë dalë rreth vdekjes së Emiliano Salas, ku thuhet se piloti David Ibboston mund të ketë kërcyer nga aeroplani para se të rrezohej. Argentinasi ndërroi jetë në janar të vitit të kaluar derisa po e kompletonte transferimin nga Nantesi te Cardiff City. Ish-lojtari i skuadrës franceze ishte në aeroplanin "Piper Malibu", por që ishte rrëzuar në brigjet e Britanisë së Madhe, duke humbur kështu jetën. Trupi i argentinasis ishte gjetur nën thellësinë e 63 metrave nga robotët kërkues, ndërsa "The Sun" raporton tani se piloti Ibboston mund t'i ketë shpëtuar rrëzimit. Në raportim thuhet se piloti ishte një ekspert i hedhjes nga aeroplani dhe mund t'i ketë shpëtuar rrëzimit, pasi trupi i tij ende nuk është gjetur. "David Ibboston kishte aftësi të mrekullueshme nga hedhja me parashutë nga aeroplanët, si mund të ndodhë që ai është zhdukur", ka shkruar Harry Harris. "Përse nuk ishte trupi i tij në aeroplan kur janë gjetur mbetjet dhe u gjet vetëm ai i Salas?". "A kishte arritur piloti të kërcente para se të rrezohej aeroplani? Ndoshta ai ka shpëtuar, nëse jo, ku është trupi i tij", ka shkruar më tej ai. Sala ishte rikthyer më 19 janar në Francë për t'i paketuar valixhet, mirëpo aeroplani me të cilën udhëtonte u rrëzua dy ditë më vonë ku nuk arriti të mbijetonte.

Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË PRIZREN**

Nr. 80/20  
Datë: 13.01.2020

Në bazë të nenit 35 të ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunitet në Kosovës, neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Udhëzimit Administrativ nr.17/2009 (MASHT) - procedura e zgjedhjes personalit arsimore në shkollë, Udhëzimi Administrativ nr. 10/2018 (MASHT) - Normativi mbi kuadrin profesional të arimit të përgjithshëm, udhëzimi administrativ nr 07/2017 (MPMS) - rregullimi i procedurave në sektorin publik, Drejtoria Komunale për Arsim shpall:




**KONKURS**  
për vende të lira pune

- Një mësimdhënës të matematikës me kohë të caktuar (Pushim i lindjës)  
SHML "Gjon Buzuku" në Prizren
- Dy mësimdhënës të Gjuhës Gjermane me kohë të caktuar (Pushim i lindjës)  
SHML "Gjon Buzuku" në Prizren
- Një mësimdhënës për Gjuhë Shqipe me kohë të pacaktuar  
SHFMU "Anif Muji" në Struzhë
- Një mësimdhënës për Lëndën e Biologjisë me kohë të caktuar (Pushim pa pagesë)  
SHFMU "Lidhja e Prizrenit" në Prizren
- Një mësimdhënës për mësim klasor me kohë të caktuar  
SHFMU "Nazim Buduri" në Hoçë të Qytetit
- Një mësimdhënës për mësim klasor me kohë të pacaktuar  
SHFMU "Vëllezrit Frashëri" në Planjë
- Një mësimdhënës për mësim klasor me kohë të caktuar (Pushim i lindjës)  
SHFMU "Lekë Dukagjini" në Prizren
- Dy mësimdhënës për mësim klasor me kohë të caktuar (Pushim i lindjës)  
SHFMU "Bajram Curri" në Romajë
- Një mësimdhënës për Gjuhë Frengje me kohë të caktuar (Pushim i lindjës)  
SHML "Remzi Ademaj" në Prizren

**Kushtet:**

- Për të gjitha vendet e punës kërkohet kualifikimi përkatës profesional, sipas Udhëzimit Administrativ nr. 10/2018 - normativi mbi kuadrin profesional të arimit të përgjithshëm,
- Kopjen e vërtetuar të diplomës
- Nostifikimin, nëse kandidati e ka të kryer shkollimin jashtë Kosovës.
- Dëshminë mbi përvojën e punës.
- Trajnimet profesionale.
- Certifikatën e lindjes.
- Kopjen e letërnjoftimit.
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore, kandidati e sjell pasi të pranohet në punë.
- Vërtetimin nga Policia e Kosovës se kandidati nuk ka qenë i dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët.
- Aplikacionet merren në DKA dhe dorëzohen të plotësuara së bashku me dokumentacionin e kërkuar në DKA.
- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë deri më datë 28.01.2020.
- Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk iu kthehet kandidatëve.

Drejtoresha: Xhemile Thaçi Vezgishi

Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të Ligjit të Punës, nr.03/L-212, neni 8 paragrafi 1 dhe 2, neni 10 nënparagrafi 2.1 dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ nr 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria Komunale për Arsim dhe Shkencë shpall:

Nr. 146/20  
Datë: 13.01.2020

**KONKURS**

- SHFMU "Emin Duraku" në Prizren, një (1) punëtor teknik (me kohë të caktuar, deri në kthimin e punëtorit)
- SHFMU "Motrat Qiriazhi" në Prizren, një (1) punëtor teknik

Orari i plotë: 40 orë në javë

**Kushtet:**

**Detyrat dhe përgjegjësit e punëtorit teknik :**

- ❖ Kujdeset për nivelin e pastërtisë së hapësirës shkollore
- ❖ Bënë pastrimin e dyshemeve, dyerëve, dritarëve, mureve, nyejeve sanitare, koridoreve etj.
- ❖ Pastrimin i rregullt i oborrit të shkollës dhe mirëmbajtja e gjelbërimit në hapësirën shkollore,
- ❖ Njofton për të gjitha dëmet dhe defektet eventuale në shkollë,
- ❖ Kujdeset për ruajtjen e objektit dhe inventarit të shkollës,
- ❖ Kryen punës,
- ❖ Kryen punë të tjera sipas kërkesës së drejtorisë së shkollës.

**Kualifikimi : Përgatitja e mesme shkollore**

Çdo kandidat (aplikues) duhet të kompletojë dhe të dorëzojë dokumentacionin e domosdoshëm (fotokopje të vërtetuar) si vijon:

- 1.Dëshmi mbi përgatitjen profesionale-kualifikimin, fotokopje e vërtetuar,
- 2.Dokumentin e identifikimit – kopje e letërnjoftimit,
3. Certifikata që nuk është në hetim dhe se nuk është i dënuar për vepra penale,
- 4.Certifikata mbi gjendjen shëndetësore.


**Aplikacionet dorëzohen në Drejtorinë Komunale për Arsim në Prizren**

**Afati i aplikimit është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shpalljes në web faqe të Komunës dhe mjetet e informimit publik.**

**Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.**  
**Sqarim :Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet do të ftohen për test me shkrim dhe në intervistë.**  
**Kandidatët të cilët gjatë testit me shkrim marrin 50% e me shumë të pikëve do të ftohen në intervistë me gojë.**

Drejtorja Komunale e Arsimit dhe Shkencës

Drejtoresha/ Xhemile Thaçi Vezgishi





Republika e Kosovë  
Republika Kosova- Republic Of Kosovo



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren-Municipality Of Prizren

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

**Në mbështetje të Ligjit për Gjuetinë Nr.02/L-53 të dt. 16.12.2005, Udhëzimi Administrativ NR. 06/2009, neni 3, Pëlqimi i MBPZHR, Zyra e Sekretarit të Përgjishëm, Ref: ZSP, 844/19 dt. 21.10.2019, Vendimi i Asambles Komunale për Themelimin e Vengjuetive të përbashkta në teritorin të Komunës së Prizrenit 001/011-61531 të dt. 25. prill. 2019, si dhe Vendimin e Kryetarit të Komunës, nr. 01-060-171639 të dt. 17.12.2019**  
**Duke u bazuar në Pëlqimin e MBPZHR, Vendimin e Asamblesë Komunale në Prizren, Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prizrenit, Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, shpallë:**

### T e n d e r i

Për dhënie me qira të Vend -Gjuetive të Përbashkta që Shtrihen në teritorin e Komunës së Prizrenit, Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rura, shpallë:

#### OFERTË PUBLIKE

Ftohen të gjithë të intersuarit, personat fizik dhe juridik, Shoqatat, Ndërmarrjet apo Agjencionet vendor dhe të huaj të cilët i plotësojnë kushtet sipas Ligjit të Gjuetisë dhe kushtet e përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ.06/2009.  
Për dhënie me qira të Vend -Gjuetive të Përbashkta që Shtrihen në teritorin e Komunës së Prizrenit.

**1. Vend Gjuetia "KORETNIKU & RRAFSHI"**  
Sipërfaqja e përgjithshme e vend-gjuetis 26.351.05 Hektar  
Sipërfaqja e aktive e vend-gjuetis 22,373.31 Hektar çmimi fillestar 1,900.00€

#### Çmimi ofertues \_\_\_\_\_

**2. Vend Gjuetia "PASHTRIK"**  
Sipërfaqja e përgjithshme e vend-gjuetis 13,648.60 Hektar  
Sipërfaqja e aktive e vend-gjuetis 22,373.31 Hektar çmimi fillestar 1,070 €

#### Çmimi ofertues \_\_\_\_\_

**3. Vend Gjuetia "SHARRI 1 & SHARRI 2"**  
Sipërfaqja e përgjithshme e vend-gjuetis 10,702.10 Hektar  
Sipërfaqja e aktive e vend-gjuetis 13,297.66 Hektar çmimi fillestar 1,410,00 €

#### Çmimi ofertues \_\_\_\_\_

Ftohen të gjithë të intersuarit, personat fizik dhe juridik, Shoqatat, Ndërmarrjet apo Agjencionet vendor dhe të huaj të cilët i plotësojnë kushtet sipas Ligjit të Gjuetisë dhe kushtet e përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ.06/2009.  
Për dhënie me qira të Vend -Gjuetive të Përbashkta që Shtrihen në teritorin e Komunës së Prizrenit, Dhënia Vendgjuetive të Përbashkta me Qira, sipas UA 06/2009, neni 5

#### Kushtet e Përcaktuara për Ofertues

- Kushtet kryesore - përveç atyre që parashihen me legjislacionin e prokurimit publik, që duhet të plotësohen për marrjen me qira të vendgjuetive të përbashkëta janë:
  - dëshmia e regjistrimit të veprimtarisë;
  - dëshmi mbi përvojën e punës në menaxhimin me kafshë të egra dhe gjueti (kjo vlen për menaxhuesit e gjertanishëm me gjueti - shoqatat e gjuetisë) nga Federata e Gjahtarëve të Kosovës dhe nga Autoritetet kontraktuese si dhe përshkrimin e rezultateve menaxhuese nga vitet paraprake;
  - dëshmi mbi përvojën e punës në menaxhim dhe rezultatet e arritura në veprimtari të ngjashme - për subjektet tjera juridike dhe fizike si në: pylltari, bujqësi, veterinë, turizëm, ekologji;
  - dëshmi për shërbimin profesional që do të angazhohet në menaxhim, duke përfshirë numrin e të punësuarve - gjuetarë të kualifikuar, roje gjuetie, profesionistë të florës dhe faunës;
  - programin për synimet e menaxhimit dhe zhvillimit të vendgjuetisë - mbrojtja dhe ruajtja, kultivimi dhe shtimi i kafshëve të egra;
  - dëshmi nga gjykata se personi përgjegjës nuk është i dënuar ose i ndjekur për vepër penale;
  - dëshmi që vërtetohet se nuk ka obligime financiare ndaj Agjencisë Tatimore të Kosovës;
  - dëshmi për posedimin e mjaftueshëm të mjeteve financiare për ushtrimin e kësaj veprimtarie;
  - çmimi më i lartë ofertues për qiranë.

#### KRITERET PËR DHËNJE TË OFERTËS

- Oferta e cila i plotson kushtet e lartëcekur dhe ka çmimin më të lartë ofertues për qiranë do të shpallet fitues i këtij projekti
- Afati për tërheqje të matritit ofertues (sipas UA NR. 06/2009, nga data 17. 01. 2020 deri me 03. 02. 2020 në ora 15:00 në zyrën e prokurimit Kuvendi Komunal Prizren si dhe në objektin e shërbimit të pylltarisë.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave, bëhen në zyrën e prokurimit do të jetë më datën 04. 02. 2020 deri në ora 13:30 \_\_\_\_\_, ndërsa hapja do të bëhet të njëjtën ditë në ora 14:00 \_\_\_\_\_

Ofertat duhet të dorëzohen në zyrën e Prokurimit të Kuvendi Komunal në Prizren, dhe duhet të jenë të mbyllura.

Hapja e ofertave në pajtim me orarin e sipërcekur, do të bëhet nga komisioni.

Informatat për Ofertuesit

Emërtimi i OE (Emri e mbiemri për personat Fizik \_\_\_\_\_)

Adresa e sakt e selisë (Vendbanimit) \_\_\_\_\_

Email adresa dhe telefoni kontaktues \_\_\_\_\_

## Dafina Veseli, shpall të pavlefshme Certifikatën e biznesit "Dafinuts" sh.p.k. me nr. 11321629. Skenderaj.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Erblin Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së dhjetë dhe njëmbëdhjetë të SH.M.T.H.T "7 Shtatori" Prishtinë.

► Agron Dedaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. Dhjetë, njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, trembëdhjetë si dhe certifikatën e notave "7 Shtatori" Prishtinë.

► Leutrim Kastrati shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "4 Dëshmorët" Rattok

► Blerim Kabashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Fadil Isari" Prizren.

► Besfort Gashi shpall te pavlefshme certifikatën shmlt "11Marsi" Prizren.

► Albenit Bytyqi shpall te pavlefshme diplomën shmlt Shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Edon Gashi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11Marsi " Prizren.

► Sadik Kokaj shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11Marsi" Prizren.

► Riza Hazeraj diplomën shmlt "11Marsi" Prizren.

► Tefik Berisha shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Hysen Z. Hyseni B.I shpall te pavlefshëm certifikatën e biznesit me numër 81111848

► Autoshkolla Anesa - Musa Mengjiqi B.I shpall te pavlefshëm certifikatën e biznesit me numer 811112854 ne Vushtrri.

► "MA" SHPK shpall te pavlefshëm certifikatën e biznesit me numër: 810345745 me pronar Kemajl Mikullovc.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralla Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare. Tel. 044-413-197.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

